



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor “E Drejtë
Biznesi”**

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë
“Tirana Business University College”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Enkeleda OLLDASHI

2. PhD. Robert GAJDA

Dhjetor/2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bachelor në “E Drejtë Biznesi”, ofruar nga Kolegji Universitar “Tirana Business University College”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “Tirana Business University College”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “E Drejtë Biznesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 794, dt. 06.10.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMASR Nr. 216, dt. 03.07.2020
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMAS Nr. 92, datë 20.03.2014
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	UMASR Nr. 326, datë 15.08.2013
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	197 ECTS*
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve:	78
19	Komente / të tjera:	Brezi i fundit i studentëve të regjistruar në këtë program është në vitin akademik 19-20, pasi programi është riorganizuar.

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

Përshkrim përmbledhës; 200 - 400 fjalë

Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 794, datë 06.10.2010, që me licensimin e Shkollës së Lartë Private “Tirana Business University”. Ky program studimi, i ofruar me kohë të plotë, në 3 vite akademike/6 semestra, me 180 ECTS, është akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH Nr. 326, datë 15.08.2013 dhe është duke ju nënshtruar procesit të akreditimit periodik. Forma e diplomës është regjistruar me Urdhër të MAS Nr. 92, datë 20.03.2014. Ky program studimi është riorganizuar, me Urdhër të MASR Nr. 216, datë 03.07.2020, në program të integruar studimi të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në “Drejtësi”, që do të fillojë veprimtarinë e tij nga viti akademik 2020-2021 dhe do të realizohet me 300 ECTS, kohëzgjatje normale 5 vite akademike/10 semestra, me formë studimi me kohë të plotë. Për sa më lart, ky proces akreditimi, do tu shërbejë brezave të studentëve që janë regjistruar në këtë program studimi deri në vitin akademik 2019-2020, deri në diplomimin e tyre.

Qëllimi i këtij programi studimi është përgatitja e juristëve të specializuar në çështje juridike private dhe administrative. Ky program synon të përgatisë juristë të aftë për të punuar në shoqëri tregtare publike dhe/ose private, në studio avokatie apo dhe në kompani ndërkombëtare. Programi synon gjithashtu të pajisë studentët me njohuri të avancuara në të drejtën civile, administrative dhe tregtare. Pajisja e studentëve me njohuri të avancuara mbi legjislacionin shqiptar, por edhe me njohuritë e nevojshme mbi legjislacionin evropian, e bën këtë program studimi të fokusuar në çështjet që lidhen me tregun global në fushën e biznesit. Programi synon të mundësojë për studentët dhe vijimin e studimeve për në ciklin e dytë. Përmes këtij programi studimi, institucioni (TBU) synon të mundësojë për studentët punësimin përpara mbarimit të studimeve.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Raporti i vlerësimit të jashtëm është një dokument i hartuar në kuadër të akreditimit periodik të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “E drejtë biznesi”, ofruar nga Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, i Kolegjit Universitar “Tirana Business University College”.

Procesi i vlerësimit të jashtëm është bazuar në Manualin e Vlerësimit dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi ka përfshirë disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm: Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV);
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion: Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është dakordësuar agenda e vizitës në Institucion dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive;
- Vizita në Institucion: u realizua në datat 24-25.09.2020. Në institucion, sipas Agjendës së miratuar më herët, janë kryer takime me: Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësin e Departamentit; Grupin e Vetëvlerësimit; Përfaqësues të stafit akademik me kohë të plotë dhe kontratë të angazhuar në programin e studimit; Përfaqësues të studentëve të programit të studimit; Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; Qendrën për Kërkime dhe Studime Ekonomike dhe Juridike; Zyrën e Çështjeve Studentore; Zyrën e Financës; Sekretarinë Mësimore, si dhe u realizua një vëzhgim i ambjenteve të Institucionit (auditoret, laboratorët, bibliotekën, zyrat e stafit, etj);
- Gjatë vizitës në Institucion, nga GVJ u kërkuan disa dokumenta shtesë, të cilat u vunë në dispozicion nga Koordinatorja Institucionale e TBU dhe u përdorën nga GVJ gjatë hartimit të raportit;
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Raporti përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kriterëve të ciklit të parë për programin Bachelor, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kriterëve respektive. Vlerësimi i jashtëm, bazuar tek standardet e cilësisë për këtë program studimi, është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: 1. Ofrimi, organizimi dhe drejtimi i programit të studimit; 2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; 3. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; 4. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistikë për realizimin e programit të studimit; 5. Studentët dhe mbështetja e tyre; 6. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit. Shkalla e përmbushjes së standardeve për çdo fushë, është përcaktuar bazuar në manualin e vlerësimit të BA/ASCAL, sipas niveleve: Standardet nuk përmbushen; Standardet përmbushen pjesërisht; Standardet përmbushen kryesisht; Standardet përmbushen plotësisht. Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi shkallën e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga: **Prof. As. Enkeleda OLLDASHI** dhe **PhD. Robert GAJDA**. Në realizimin e këtij procesi vlerësimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Msc. Ersi Dako.

Më datë 24.11.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 53/20 Prot., datë 24.11.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, më datë 04.12.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 48/4 Prot., datë 04.12.2020, përcjell komentet mbi Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. GVJ, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL, shprehet si vijon:

1. Në lidhje me **rekomandimin 2**: Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të DVV dhe intepretimit tonë si GVJ, i qëndrojmë konstatimit tonë të bërë në raport se në disa prej lëndëve të programit, sikurse përmendur në analizën tonë, titullarët nuk kanë kualifikimin e kërkuar nga parashikimet ligjore, neni 59, pika 3 e ligjit 80/2015.


Lidhur me komentin e IAL mbi komunikimet me MASR, GVJ thekson se ky komunikim i përket një procesi tjetër vlerësimi, të realizuar nga një Institucion tjetër, i cili nuk është objekt gjykimi dhe vlerësimi në kuadër të këtij procesi vlerësimi që po realizohet dhe që ne si GVJ nuk kemi tagrin ta gjykojmë e vlerësojmë. Ne si GVJ, në analizën dhe intepretimin tonë, bazohemi në dokumentacionin e përcjellë nga IAL, parashikimet e kërkesat ligjore dhe eksperiencën tonë si ekspertë të fushës.

Lidhur me komentin e IAL se *“në dijeninë tonë, në të gjitha IAL-të publike apo private në Republikën e Shqipërisë, stafet akademike me gradën Doktor Shkencash janë gjithashtu edhe titullarë lëndësh”*, GVJ thekson se krahasimi me IAL-të e tjera në Republikën e Shqipërisë nuk është objekt i këtij procesi vlerësimi, ku GVJ po vlerëson programin e studimit Bachelor në “E drejtë biznesi”, të ofruar nga TBU. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.

2. Në lidhje me **rekomandimin 3 dhe 6**: Lidhur me këtë pikë raporti nuk ndryshon, pasi argumentimi/konstatimi i bërë nga GVJ në këtë pikë është bërë bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL dhe vizitën në Institucion në bibliotekën e Institucionit. Gjithashtu, lidhur me komentin e IAL për bibliotekën elektronike, GVJ shprehet se në argumentimin e tij në këtë pikë, nuk ka përmendur ndonjë mangësi lidhur me të.

3. Në lidhje me **rekomandimin 5 dhe 10**: Lidhur me rritjen e kualifikimit shkencor të personelit akademik dhe mbështetjes së IAL, GVJ nuk pasqyron ndryshim në raport pasi GVJ në argumentimin e tij i është referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL.

Lidhur me publikimet në TBU Press, në link-un e vënë në dispozicion nga IAL, evidentohen dhe dy raste të tjera të mbështetjes nga TBU, ku një prej autorëve nuk është personel akademik i këtij programi/departamenti (bazuar në tabelat e përcjella nga TBU), ndërsa autori tjetër është pjesë e listës së personelit akademik të këtij programi në vitin akademik 18-19. Gjithsesi, mbështetja e Institucionit, sikurse publikuar, ka qenë tre



botime që prej vitit 2016, që gjithsesi mbeten raste sporadike. Përveç sa më sipër, GVJ, në argumentimin e tij, i është referuar mungesës së një strukturimi dhe kriterëve të mirëpërcaktuara për këtë lloj mbështetje të ofruar nga Institucioni. Gjithsesi, për saktësim, edhe pse nuk do të pasqyrohet ndryshim në vlerësim, në argumentimin e GVJ për këtë pikë, do të shtohet dhe komenti lidhur me mbështetjen e TBU Press për botimet e dy autorëve të tjerë.

Lidhur me revistën shkencore, do të shtohet në argumentimin e GVJ fakti i bashkëpunimit të TBU me “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” (ku Dekani i Fakultetit që ofron këtë program studimi është anëtar i Bordit Shkencor Ndërkombëtar), për botimin e revistës “Balkan Journal of Interdisciplinary Research” (ku Dekani i Fakultetit është Kryeredaktor). Gjithsesi, theksohet se rekomandimi i lënë nga akreditimi i mëparshëm i referohet botimit të një reviste shkencore të vetë TBU.

Lidhur me komentin e IAL për planin e veprimit dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga akreditimi institucional, GVJ thekson se kjo i përket një procesi tjetër vlerësimi dhe jo këtij procesi vlerësimi në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Për gjithë sa më lart, komenti i TBU merret pjesërisht në konsideratë. Vlerësimi për rekomandimin 10 ndryshon nga “Përmbushet pjesërisht” në “Përmbushet kryesisht”.

4. Në lidhje me **standardin II.3, kriteri 3**: Pas komentit të institucionin në lidhje me këtë pikë, GVJ do të pasqyrojë ndryshimet përkatëse në pjesët e raportit dhe do të shtojë paragrafin si më poshtë vijon: *“Studentët kanë fituar në vitin e tretë akademik 60 ECTS të detyrueshme, edhe pse disa studentë kanë fituar më shumë kredite, pasi kanë pasur mundësi të marrin edhe lëndë mbi këtë numër kreditesh (pa pagesë shtesë). Gjithsesi, në planin mësimor të vitit akademik 2019-2020, ky fakt nuk është pasqyruar saktësisht”*.
5. Në lidhje me **standardin II.3, kriteri 7**: Ndryshimet e realizuara në planin mësimor të vitit akademik 2019-2020, në masën mbi 20%, janë miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 3, datë 20.06.2019 *“Mbi miratimin e rregulloreve të programeve të studimit në zbatim të VKM-së “Për elementët e programeve të studimit”*”. Për këto ndryshime Institucioni ka njoftuar MASR me shkresën Nr. 43 Prot., datë 18.10.2019 dhe MASR ka konfirmuar marrjen dijeni për ndryshimet me shkresën me Nr. 9579/1 Prot., datë 05.11.2019. Për sa më lart, ky ndryshim do të pasqyrohet në raport dhe vlerësimi për këtë standard ndryshon në “përmbushet plotësisht”.
6. Në lidhje me **standardin II.5, kriteri 1**: Sikurse argumentuar edhe më lart në përgjigjen tone në pikën 1, bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të DVV dhe interpretimit tonë si GVJ, i qëndrojmë konstatimit tonë të bërë në raport se në disa prej lëndëve të programit, titullarët nuk kanë kualifikimin e kërkuar nga parashikimet ligjore, neni 59, pika 3 e ligjit 80/2015.
Lidhur me komentin e IAL mbi komunikimet me MASR, GVJ thekson se ky komunikim i përket një procesi tjetër vlerësimi, të realizuar nga një Institucion tjetër, i cili nuk është objekt gjykimi dhe vlerësimi në kuadër të këtij procesi vlerësimi që po realizohet dhe që ne si GVJ nuk kemi tagrin ta gjykojmë e vlerësojmë. Ne si GVJ, në analizën dhe

intepretim tonë, bazohemi në dokumentacionin e përcjellë nga IAL, parashikimet e kërkesat ligjore dhe eksperiencën tonë si ekspertë të fushës.

Lidhur me komentin e IAL se *“në dijeninë tonë, në të gjitha IAL-të publike apo private në Republikën e Shqipërisë, stafet akademike me gradën Doktor Shkencash janë gjithashtu edhe titullarë lëndësh”*, GVJ thekson se krahasimi me IAL-të e tjera në Republikën e Shqipërisë nuk është objekt i këtij procesi vlerësimi, ku GVJ po vlerëson programin e studimit Bachelor në “E drejtë biznesi”, të ofruar nga TBU. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.

7. Në lidhje me **standardin III.1, kriteret 2, 3, 4 dhe 5**: GVJ, në hartimin e raportit të tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL, në përputhje kjo me aktet rregullatore të ASCAL (Manual). Për sa më lart raporti nuk ndryshon.
8. Në lidhje me **standardin III.3, kriteri 5**: Sikurse përmendur dhe më lart, lidhur me këtë pikë raporti nuk ndryshon, pasi argumentimi/konstatimi i bërë nga GVJ në këtë pikë është bërë bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL dhe vizitën në Institucion në bibliotekën e Institucionit. Gjithashtu, lidhur me komentin e IAL për bibliotekën elektronike, GVJ shpreh se në argumentimin e tij në këtë pikë, nuk ka përmendur ndonjë mangësi lidhur me të.
9. Në lidhje me **standardin IV.1, kriteri 4**: Si rregull rekrutimet në një IAL duhet të bëhen me konkurs në mënyrë që të garantohet një garë e hapur dhe transparente, por edhe t’i ofrohet mundësi çdokujt që të mund të kandidojë. Është e kuptueshme që IAL kanë diskrecion në përzgjedhjen e stafit në disa raste dhe për disa fusha specifike por edhe për personalitete të shquara në disa fusha interesi. Por, këto duhet të jenë përjashtimore dhe jo rregull pasi i gjithë impianti rregullator për rekrutimin nuk do të kishte kuptim dhe nuk do të zbatohet asnjëherë nëse për çdo rast IAL do të vendoste në mënyrë subjektive rekrutimin e stafit. Në këtë kontekst raporti nuk ndryshon dhe rekomandohet që IAL të kryejë procedura rekrutimi në bazë nevojash dhe kriteresh të mirëpërcaktuara dhe në vlerësim të aftësive të konkuresve, në zbatim të Rregullores së saj, duke i dhënë mundësinë dhe të drejtën personave të interesuar për t’u bërë pjesë e stafit të IAL.
10. Në lidhje me **standardin IV.2, kriteri 2**: Lidhur me këtë pikë, GVJ mban të njëjtin qëndrim si më lart. Lidhur me rritjen e kualifikimit shkencor të personelit akademik dhe mbështetjes së IAL, GVJ nuk pasqyron ndryshim në raport pasi GVJ në argumentimin e tij i është referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL.
Lidhur me publikimet në TBU Press, në link-un e vënë në dispozicion nga IAL, evidentohen dhe dy raste të tjera të mbështetjes nga TBU, ku një prej autorëve nuk është personel akademik i këtij programi/departamenti (bazuar në tabelat e përcjella nga TBU), ndërsa autori tjetër është pjesë e listës së personelit akademik të këtij programi në vitin akademik 18-19. Gjithsesi, mbështetja e Institucionit, sikurse publikuar, ka qenë tre botime që prej vitit 2016, që gjithsesi përbën një numër të vogël të rasteve. Përveç sa më

sipër, GVJ, në argumentimin e tij, i është referuar mungesës së një strukturimi dhe kritereve të mirëpërcaktuara për këtë lloj mbështetje të ofruar nga Institucioni. Gjithsesi, për saktësim, edhe pse nuk do të pasqyrohet ndryshim në vlerësim, në argumentimin e GVJ për këtë pikë, do të shtohet dhe komenti lidhur me mbështetjen e TBU Press për botimet e dy autorëve të tjerë.

Lidhur me revistën shkencore, do të shtohet në argumentimin e GVJ fakti i bashkëpunimit të TBU me “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” (ku Dekani i Fakultetit që ofron këtë program studimi është anëtar i Bordit Shkencor Ndërkombëtar), për botimin e revistës “Balkan Journal of Interdisciplinary Research” (ku Dekani i Fakultetit është Kryeredaktor).

Lidhur me komentin e IAL për planin e veprimit dhe përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga akreditimi institucional, GVJ thekson se kjo i përket një procesi tjetër vlerësimi dhe jo këtij procesi vlerësimi në kuadër të akreditimit të programit të studimit.

Për gjithë sa më lart, komenti i TBU merret pjesërisht në konsideratë, duke pasqyruar në raport saktësimet e sipërpërmendura, por gjithsesi vlerësimi për standardin nuk ndryshon.

11. Në lidhje me **standardin IV.2, kriteri 3**: GVJ konkludon që raporti në këtë pikë nuk ndryshon pasi bazuar në verifikimin dhe analizën e bërë nuk rezulton që të jetë organizuar ndonjë veprimtari specifike lidhur me metodologjinë dhe pedagogjinë e mësimdhënies apo metodave inovative në këtë drejtim.
12. Në lidhje me **standardin IV.4, kriteri 2 dhe 5**: Sikurse përmendur dhe në dy prej komenteve më lart, lidhur me këtë pikë raporti nuk ndryshon, pasi argumentimi/konstatimi i bërë nga GVJ në këtë pikë është bërë bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga IAL dhe vizitën në Institucion në bibliotekën e Institucionit. Gjithashtu, lidhur me komentin e IAL për bibliotekën elektronike, GVJ thekson se në argumentimin e tij në këtë pikë, nuk ka përmendur ndonjë mangësi lidhur me të.
13. Në lidhje me **standardin IV.6, kriteri 1 dhe 3**: Komenti i IAL merret në konsideratë dhe pasqyrohet ndryshimi në tekst duke hequr dy fjalitë përkatëse. Gjithashtu, vlerësimi për shkallën e përmbushjes së këtij standardi ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”.
14. Në lidhje me **standardin V.4, kriteri 3**: GVJ në këtë gjetje të tijën i është referuar të dhënave të konstatuara gjatë kohës së zhvillimit të vizitës në Institucion. GVJ mirëkupton situatën e përmendur nga Institucioni dhe nuk vë aspak në dyshim plotësimin e të dhënave nga ana e Institucionit, pas vizitës së GVJ në IAL, por GVJ në raportin e tij duhet të pasqyrojë të dhënat dhe gjendjen sikurse është konstatuar gjatë vizitës. GVJ mendon se që prej vitit akademik 18-19 ka qenë një kohë relativisht e gjatë për të pasqyruar të dhënat përkatëse në regjistër, sikurse ishte realizuar tashmë edhe për një program tjetër të konstatuar gjatë vizitës. Për sa më lart, raporti nuk ndryshon.

15. Në lidhje me **standardin V.4, kriteri 5**: Pas rishqyrtimit të dokumentacionit të patur më herët në dispozicion, GVJ pranon komentën e IAL duke hequr fjalinë përkatëse në këtë pikë të raportit. Gjithashtu, vlerësimi për shkallën e përmbushjes së këtij standardi ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”.

16. Në lidhje me **standardin V.5, kriteri 1**: GVJ pranon komentën e IAL për këtë pikë duke hequr fjalinë përkatëse në këtë pikë të raportit. Gjithashtu, vlerësimi për shkallën e përmbushjes së këtij standardi ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”.

❖ Për rrjedhojë të ndryshimeve të pasqyruara në fushën 5, pas komenteve të IAL, vlerësimi për këtë fushë të raportit ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”.

17. Në lidhje me **standardin V.6, kriteri 1, 2**: Në këtë pikë GVJ i është referuar mungesës së një rregulloreje specifike mbi të cilën bazohet funksionimi i Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët. Sikurse edhe është përmendur, Statuti i IAL dikton nevojën e pasjes së një rregulloreje të miratuar nga Senati Akademik mbi të cilën do të veprojë ky komision. Rregullorja e paraqitur nga IAL, citojmë “*Rregullore për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale në TBU*”, nuk nxjerr në pah në mënyrë të qartë e të detajuar rolin e kësaj strukture, funksionin, veprimtarinë që realizon, etj. Pavarësisht rolit që kjo strukturë ka (*sipas IAL në koment jo operacionale*), nevojitet të ketë një parashikim të qartë për sa përmendur më lart.

Për sa i përket krahasimit të bërë nga IAL me shkollat e tjera, GVJ mendon se nuk është i përshtatshëm, pasi GVJ është duke vlerësuar këtë program studimi specifik të ofruar nga TBU dhe krahasime të tilla nuk janë objekt i këtij vlerësimi.

Lidhur me dokumentat e bashkëngjitura nga IAL për këtë koment, GVJ, sikurse ka përmendur edhe më lart, thekson se në hartimin e raportit nga ana e tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.

18. Në lidhje me **standardin VI.1, kriteri 1**: Në këtë pikë GVJ i është referuar mungesës së një rregulloreje specifike mbi të cilën bazohet funksionimi i Komisionit të Cilësisë. Sikurse edhe është përmendur, Statuti i IAL dikton nevojën e pasjes së një rregulloreje të miratuar nga Senati Akademik mbi të cilën do të veprojë ky komision. Rregullorja e paraqitur nga IAL, citojmë “*Rregullore për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale në TBU*”, nuk nxjerr në pah në mënyrë të qartë e të detajuar rolin e kësaj strukture, funksionin, veprimtarinë që realizon, etj. Pavarësisht rolit që kjo strukturë ka (*sipas IAL në koment jo operacionale*), nevojitet të ketë një parashikim të qartë për sa përmendur më lart.

Lidhur me dokumentat e bashkëngjitura nga IAL për këtë koment, GVJ, sikurse ka përmendur edhe në pika të tjera më lart, thekson se në hartimin e raportit nga ana e tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe

vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.

19. Në lidhje me **standardin VI.1, kriteri 4:** GVJ, sikurse dhe më herët, thekson se në hartimin e raportit nga ana e tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.
20. Në lidhje me **standardin VI.2:** GVJ, sikurse dhe më herët, thekson se në hartimin e raportit nga ana e tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.
21. Në lidhje me **standardin VI.2, kriteri 5:** GVJ, sikurse dhe më herët, thekson se në hartimin e raportit nga ana e tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL. Bazuar në këtë dokumentacion, evidentohen konstatimet e paraqitura nga GVJ në raport. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.
22. Në lidhje me **standardin VI.3:** GVJ shprehet se konstatimi i bërë në këtë paragraf është në formën e një rekomandimi për IAL. Duke riparë edhe njëherë qëndrimin e GVJ, vlerësimi për këtë standard ndryshon nga “përmbushet kryesisht” në “përmbushet plotësisht”.
23. Në lidhje me **standardin VI.4, kriteri 5:** Lidhur me këtë pikë, GVJ dëshiron të theksojë se, sikurse është bërë edhe hartimi i fjalisë, është një sugjerim për të ardhmen që IAL mund ta konsiderojë. Ky sugjerim vijon të jetë një sugjerim për të ardhmen dhe i takon IAL ta marrë atë në konsideratë ose jo. Në vijim të sa më lart, raporti në këtë pikë nuk ndryshon dhe gjithashtu as vlerësimi për këtë standard, pasi për vlerësimin e tij GVJ i është referuar në tërësi të gjitha kritereve të këtij standardi. Lidhur me komentën për Komisionin, GVJ i qëndron argumentimit të tij të bërë më lart në komentën për pikën VI.1. Për sa më lart, raporti nuk ndryshon.
24. Në lidhje me **standardin VI.5, kriteri 3:** GVJ, sikurse dhe më herët, thekson se në hartimin e raportit nga ana e tij, bazohet në dokumentacionin e përcjellë nga IAL si pjesë të Dosjes së Vetëvlerësimit dhe vizitën e realizuar në Institucion e dokumentat shtesë të kërkuara gjatë vizitës në IAL. Bazuar në këtë dokumentacion, evidentohen konstatimet e paraqitura nga GVJ në raport. Për gjithë sa më lart, raporti nuk ndryshon.

Shënim: Zgjatja e periudhës së vlerësimit të jashtëm, ka ardhur si pasojë e kushteve të jashtëzakonshme të pandemisë së COVID-19. Komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

I. Këshilli i Akreditimit, me Vendimin Nr. 506, datë 18.07.2013, ka përcaktuar këto rekomandime për programin e studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi”:


1. Të përmirësohet raporti: nr. pedagogëve efektivë/nr. pedagogëve me kontratë, pasi aktualisht nuk plotësohet kriteri 70% pedagogë efektivë.
2. Të shmanget përfshirja e titullarëve të lëndëve që nuk kanë gradën “Doktor”.
3. Të vendoset theksi në përmirësimin dhe azhurnimin e vazhdueshëm të programeve të këtyre profileve duke u bazuar në autorë të njohur të vendit dhe botërorë, literaturë e zgjeruar, përditësuar dhe pasuruar me botimet e fundit në fushën e së drejtës së biznesit dhe disiplinave të lidhura me të, në ndihmë të realizimit të objektivave të programit të studimit.
4. Të krijohen dhe formalizohen marrëveshje me universitete prestigjiozë jashtë vendit, për të bërë shkëmbime dhe për të përfituar nga përvoja e këtyre universiteteve.
5. Të rritet mundësia e kualifikimit shkencor, me mbështetje të posaçme nga ana e IAL-së për pedagogët efektivë dhe titullarëve të disiplinave të caktuara.
6. Biblioteka e institucionit, të përditësohet/azhurnohet në mënyrë të vazhdueshme me botime të reja librash dhe revista shkencore të fushës së Drejtës së Biznesit, si dhe të realizohet akses në librari elektronike.
7. Të shmanget përqendrimi i disa lëndëve të një pedagog i vetëm.
8. Të përcaktohen politika të qarta në të ardhmen për rritjen e numrit të studentëve me qëllim përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme për ecurinë e IAL TBU.
9. Të bëhet shumë promovim për tërheqjen në këtë profil studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga gjimnazi apo transferime të ndryshme brenda IAL-ve, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushën e së drejtës së biznesit.
10. Për drejtuesit e IAL TBU, krahas seminareve, simpoziumeve të ndryshme, të organizojnë dhe konferenca shkencore, si dhe të krijojnë revistë shkencore, ku të marrin pjesë pedagogë të ndryshëm me punimet e tyre shkencore, kjo në funksion të rritjes së cilësisë së IAL TBU.

II. Vlerësimi i GVJ mbi shkallën e përmbushjes së rekomandimeve:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Rekomandimi 1: Institucioni, ka përmirësuar ndër vite numrin/raportin ndërmjet pedagogëve me kohë të plotë (PAE) dhe atyre me kontratë (PAK), të cilët angazhohen në këtë program studimi. Numri i stafit akademik të angazhuar dhe ngarkesa mësimore e mbuluar prej tyre, në tre vitet e fundit është si në vijim:

Viti akademik 19-20: 14 PAE dhe 9 PAK; 76 % e ngarkesës mësimore mbulohet nga stafi PAE dhe 24 % nga stafi PAK.

Viti akademik 18-19: 15 PAE dhe 10 PAK; 73.5 % e ngarkesës mësimore mbulohet nga stafi PAE dhe 26.5 % nga stafi PAK.

Viti akademik 17-18: 9 PAE dhe 12 PAK; 67.5 e ngarkesës mësimore mbulohet nga stafi PAE dhe stafi 32.5 % nga stafi PAK.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Rekomandimi 2: Institucioni, edhe pse ka bërë përpjekje për të përfshirë në këtë program studimi staf akademik me tituj akademik, sërish, ka disa lëndë, ku titullari nuk i përket kategorisë “Profesor”, sikurse kërkohet nga Neni 59, pika 3, e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Lëndë të tilla janë psh. “E Drejtë Penale”, “Gjykimi Administrativ”, “E Drejta e Punës”, “E drejtë private”, “Përgjegjësia Civile dhe Penale e Biznesit”, “Komunikimi profesional dhe akademik”, etj.

Rekomandimi është përmbushur kryesisht.

Rekomandimi 3 dhe 6: Biblioteka është e pajisur fizikisht me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj si edhe me revista shkencore. Ajo mbulon një pjesë të madhe të literaturës së kërkuar për mbulimin e moduleve të veprimtarisë mësimore. Gjithsesi, evidentohet mungesa e disa teksteve të nevojshme për programin e studimit dhe një numër i vogël i kopjeve të teksteve të disponueshme. Lidhur me përditësimin e fondit të bibliotekës, ndryshe nga sa referohet në RVB (fq. 33) nuk rezulton që të ketë një plan të detajuar për Bibliotekën e Institucionit. Paçka se kjo parashikohet në planin për Bibliotekën, nuk ka një procedurë të detajuar në lidhje me pikën 1 të Urdhërit të Rektorit Nr. 15, datë 18/10/2019.

Rekomandimet janë përmbushur kryesisht.

Rekomandimi 4: Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete jashtë vendit, në kuadër të bashkëpunimit akademik, si psh. me Staffordshire University, School of American Law, University of Bialystok, etj.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Rekomandimi 5 dhe 10: Institucioni ka një Strategji të Kërkimit Shkencor si dhe një Qendër për kërkimin shkencor, e cila përpilon edhe Raport vjetor për veprimtarinë e saj. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me Zyrën e Financës dhe Administratorin e TBU, u sqarua se në

Planin Buxhetor Afatmesëm parashikohet që 20 % e buxhetit dedikohet për kërkimin shkencor, dhe më së shumti kjo shifër reflektohet në pagat mujore të stafit. *Megjithatë, rezulton se formimi shkencor dhe rritja e mëtejshme e stafit akademik mbeten kryesisht iniciativë individuale.*

Për këtë program studimi, që prej vitit 2016, evidentohen tre raste të mbështetjes nga Institucioni me suport financiar për botim, ku një është pedagog me kohë të plotë në këtë program, një nuk është personel akademik i këtij programi/departamenti (bazuar në tabelat e përcjella nga TBU) dhe autori tjetër është pjesë e listës së personelit akademik të këtij programi në vitin akademik 18-19. *Gjithsesi kjo mbështetje mbetet sporadike dhe jo e strukturuar në vazhdimësi dhe në bazë kriteresh të mirëpërcaktuara.*

Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik të programit të studimit, organizimin e konferencave shkencore kombëtare, seminareve, debateve shkencore të fushës së jurisprudencës, ku janë ftuar edhe personalitete të njohura akademike. Lidhur me revistën shkencore, Institucioni bashkëpunon me “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” (ku Dekani i Fakultetit që ofron këtë program studimi është anëtar i Bordit Shkencor Ndërkombëtar), për botimin e revistës “Balkan Journal of Interdisciplinary Research” (ku Dekani i Fakultetit është Kryeredaktor), megjithatë Institucioni, sikurse kërkohet nga rekomandimi i lënë nga akreditimi i parë, ende nuk disponon një revistë të vetën shkencore.

Rekomandimi 5 është përmbushur kryesisht.

Rekomandimi 10 është përmbushur kryesisht.

Rekomandimi 7:

Institucioni, në tre vitet e fundit, duke rritur numrin e stafit PAE, ka bërë një shpërndarje dhe përfshirje të pedagogëve si titullarë të lëndëve/moduleve në jo më shumë se në tre lëndë/module.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Rekomandimi 8 dhe 9: Institucioni ndjek një politikë të mirëpërcaktuar në pranimin e studentëve, të bazuar në kriteret të përgjithshme dhe të posaçme. Lidhur me kuotat e pranimit ato janë të kufizuara, pasi sipas IAL, vihet theksi tek cilësia e studentëve. Bazuar në të dhënat financiare të paraqitura, mund të thuhet se Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit.

Institucioni, përmes bashkëpunimit të të gjitha strukturave të tij, ndjek disa politika marketingu, si:

- Konkursi kombëtar “Juristët e në nesërme”, i cili organizohet në formën e një “gjqyqi imitues”, ku ftohen të marrin pjesë gjimnazistë (kryesisht maturantë) nga i gjithë vendi, me

prirje dhe pasion drejtësinë. Ky konkurs shërben për të identifikuar e mbështetur me bursa të rinj me iniciativë dhe potencial për tu zhvilluar në fushën juridike;

- Pjesëmarrja në aktivitete të këshillimit të karrierës: TBU angazhohet të marrë pjesë në çdo aktivitet që lidhet me orientimin dhe këshillimin për maturantë dhe të rinj, si panairë, ditë informimi, etj.;

- Organizimi i aktiviteteve formuese në/nga TBU: në mjediset e Institucionit organizohen aktivitete të ndryshme formuese që lidhen me programin e studimit dhe/ose i shërbejnë rritjes personale dhe profesionale të studentëve, dhe inkurajon pjesëmarrjen e komunitetit (gjimnazistë, pedagogë, stafe të kompanive partnere, etj);

- Takime në TBU: institucioni mirëpret çdo ditë kandidatë të interesuar për vijim e studimeve;

- Marketingu digjital: promovimi i njoftimeve dhe aktiviteteve në faqen e internetit dhe rrjetet sociale;

- Partneriteti me kompanitë: për të vlerësuar bashkëpunimin me subjekte partnere, institucioni kujdeset të ofrojë reduktim të tarifës/bursës për stafet e tyre që dëshirojnë të ndjekin studimet. Kompanitë partnere informohen me email, si rregull, në periudhën korrik-shtator të çdo viti akademik.

Rekomandimet janë përmbushur plotësisht.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “E Drejtë Biznesi”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, i ofruar nga Tirana Business University College (TBU), është në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit. Qëllimi i institucionit është edukimi dhe punësimi i studentëve në përshtatje me fushën e tyre të studimit (<i>neni 8 i Statutit</i>). Për realizimin e qëllimit të tij, institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi me kompanitë dhe organizatat përfaqësuese të biznesit (<i>neni 8/4 i Statutit</i>). Programi i studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” është pjesë e Departamentit të Lëndëve të Përgjithshme/Fakultetit të Drejtësisë. Përmbajtja e këtij programi është në përputhje me interesat kombëtare, pasi në këtë program ofrohen lëndë që synojnë formimin e përgjithshëm të studentëve, me njohuri në të drejtën e brendshme publike dhe private. <i>Aneksi 2; Aneksi 3.1; Aneksi 32</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” synon të promovojë arritjet e kërkimit akademik në fushën e së drejtës, përmes përmbajtjes së lëndëve specifike dhe përmes aktiviteteve ekstra kurikulare në formën e trajnimeve, ceremonive promovuese në fushën e jurisprudencës. <i>Aneksi shtesë S.6 (gjatë vizitës); Minutat e takimit me stafin akademik</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ka si mision të tij edukimin e studentëve më njohuri bazë në fushën e së drejtës dhe me njohuri të avancuara në fushën e të drejtës private, si dhe angazhimin e tyre në veprimtari kërkimore shkencore (<i>neni 8/5 i Statutit dhe neni 3 i rregullores së programit të studimit</i>). Misioni i institucionit i shprehur në Strategjinë e Zhvillimit institucional dhe atë të kërkimit shkencor përputhet dhe me qëllimin e këtij programi studimi. <i>Aneksi 2; Aneksi 3.1; Aneksi 3.2; Aneksi 7</i>
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimin apo nevojat për zhvillim ekonomik të vendit. Kjo realizohet përmes përfshirjes në këtë program studimi të moduleve që lidhen me nxitjen e edukimit ligjor në fushën ekonomike (lënda “Sjellja Organizative”).

	Aneksi 14.1; Aneksi 19			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është hartuar duke u bazuar në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit, dokumenti i rishikuar dhe miratuar në dhjetor 2018. Qëllimi i kësaj strategjie është ofrimi i një edukimi sa më cilësor për studentët dhe përpushmëria e këtij formimi me kërkesat e tregut të punës. Ky qëllim gjendet dhe në Statutin e institucionit (neni 8).</p> <p>Në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ofrohen lëndë që synojnë përputhjen e edukimit teorik me atë praktik/profesional. Në çdo vit akademik ofrohet lënda praktika profesionale: në vitin e parë me 3 ECTS, në vitin e dytë me 5 ECTS dhe në vitin e tretë me 7 ECTS.</p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 3.1; Aneksi 14.1</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Statuti dhe rregullorja e institucionit janë hartuar në funksion të realizimit të misionit akademik dhe shkencor të këtij institucioni. Në këto dokumente themelore për funksionimin e procesit mësimor janë të renditura qartë synimet/objektivat akademike, të cilat theksojnë faktin e ndërlidhjes së njohurive teorike të përfuara në auditor me ato praktike të konkretizuara në mjediset e punës (neni 8 i Statutit).</p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 5</i></p>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike (6 semestra) me 180 ECTS (neni 4 i rregullores së programit të studimit).</p> <p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, që në emërtimin e tij, synon të ofrojë një grup lëndësh të dedikuara fushës së biznesit. Ky grup lëndësh në raport me grupin tjetër të lëndëve është në masën 30 %.</p> <p>Lëndët që lidhen më ngushtësisht me emërtimin e këtij programi janë kryesisht lëndët e kategorisë C si: “Hyrje në Biznes” me 5 ECTS - lëndë me zgjedhje; “Sjellja Organizative” me 5 ECTS - lëndë me zgjedhje; “Siguria në Biznes dhe Shërbimet e Sigurisë” me 6 ECTS - lëndë me zgjedhje; “Anglishtja e Biznesit” me 5 ECTS - lëndë me detyrim/kategoria B.</p> <p>Në këtë program studimi ka dhe lëndë të kategorisë A dhe B që lidhen sërish me emërtimin e programit si: “Komunikimi profesional dhe akademik” me 10 ECTS; “E Drejta e Shoqërive Tregtare” me 6 ECTS; “E Drejta Private” me 5 ECTS; “Pronësia Intelektuale” me 6 ECTS, etj.</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është i organizuar duke u bazuar në aktet e brendshme administrative të institucionit si Statuti, Rregullorja për programet e studimit dhe procesin mësimor, Rregullorja e organizimit, funksionimit dhe procedurave të njëjësive bazë dhe Rregullorja e programit të studimit. Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” (neni 3) ka të përcaktuar qartë objektivat e këtij programi studimi, të cilat lidhen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pajisjen e studentit me njohuri bazë dhe të avancuara në fushën e së drejtës civile, administrative dhe tregtare; - pajisjen e studentit me njohuri në të drejtën europiane; - pajisjen e studentit me njohuri praktike mbi shoqëritë tragtare; - aftësimin e studentëve me shprehitë e duhura ligjore të nevojshme për tregun e punës në fushën e marrëdhënieve juridiko-ekonomike. <p><i>Aneksi 2; Aneksi 5; Aneksi 6; Aneksi 7</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Tirana Business University College (TBU) ka kryer studimin periodik të tregut, sipas dokumentit “<i>Studimi për tregun e punës pas daljes studentëve</i>”, Janar 2020. Ky dokument është hartuar nga zyra e karrierës dhe punësimit. Baza e të dhënave lidhet me: të dhënat e grumbulluara nga anketimet e të diplomuarve; opinionet e përfaqësuesve të kompanive/subjekteve partnere; informacionet nga Banka e Shqipërisë dhe Banka Botërore. Nga të dhënat që gjenden në këtë dokument rezulton që 97 % e të punësuarve (të diplomuar në TBU) janë të punësuar në sektorin privat dhe 3 % në sektorin publik. Punësimi në sektorin privat është në zyra konsulence ligjore, menaxhim të pasurive të paluajtshme, edukim, shëndetësi, banka dhe institucione financiare. Në këtë dokument jepet informacion dhe në lidhje me kuotat e pranimit për vitin akademik 2020-2021, të cilat rekomandohen të qëndrojnë në numrin aktual të pranimeve nga 20 deri në 30 kuota.</p> <p>Në “Studimin e tregut të punës”, të realizuar nga institucioni përpara hapjes së programeve të studimit, ka një analizë në lidhje me treguesit e pranimeve në dy nga fakultetet e Universitetit të Tiranës (Fakulteti Ekonomik dhe Juridik) dhe në disa nga universitetet private në vend. Universitetet private janë ndarë në këtë studim si universitete konkurruese në lidhje me numrin e pranimeve të ofruara dhe në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

	<p>universitete më pak konkurruese Këta tregues kanë ndihmuar institucionin për të fokusuar ofertën e tij akademike vetëm në dy fusha kryesore studimi (ekonomike dhe juridike). Kjo lidhet nga institucioni dhe me faktin që TBU është institucion i vogël dhe fokusi në dy degë kryesore do të ndihmojë në angazhimin e një stafi më të kualifikuar dhe në ofrimin për studentët të një procesi akademik që lidh teorinë e përfutur në auditor me praktikën akademike. Në këtë studim gjendet një analizë SWOT që lidhet me sa më sipër. Ky është një studim në nivel institucional dhe i referohet programeve të studimit të ciklit të parë në degët Juridik dhe Ekonomik.</p> <p><i>Aneksi 16; Aneksi 17</i></p>								
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ka një strukturë akademike e cila ofron grupet e lëndëve që mundësojnë ofrimin e dijeve bazë në fushën e së drejtës dhe njohuri më të avancuara në fusha specifike si: e drejta private, tregtare dhe administrative.</p> <p>Programi i studimit ka dhe lëndë që ofrojnë njohuri të lidhura me aftësimin e studentëve për në tregun e punës si praktika profesionale me 15 ECTS (ofruar në përgjatë tre viteve akademike). Zhvillimi i praktikave profesionale në çdo vit akademik rrit mundësitë e pajisjes së studentëve me shprehitë praktike dhe në të njëjtën kohë rrit mundësinë e kontakteve me aktorët e tregut të punës, duke mundësuar një punësim më të shpejtë të tyre. Institucioni ka të dhëna që lidhen me punësimin e studentëve jo vetëm pas diplomimit, por edhe gjatë periudhës së studimeve.</p> <p><i>Aneksi 29; Aneksi shtesë S.3 (gjatë vizitës)</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4

Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Tirana Business University College (TBU) përbëhet nga dy fakultete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Fakulteti i Administrimit Biznesit, i cili ka në përbërjen e tij tre departamente (Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme; Departamenti i Menaxhimit; Departamenti i Kontabilitet-Financës); 2. Fakulteti i Drejtësisë, i cili ka në përbërjen e tij dy departamente (Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme dhe Departamenti i Lëndëve Profesionale) dhe një Qendër për kërkime a studime ekonomike dhe juridike (<i>neni 3 i rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurat e njësive bazë</i>). <p>Të gjitha njësitë bazë të Fakultetit të Drejtësisë (tre njësi), mbështesin në aspektin akademik dhe shkencor realizimin e planit mësimor</p>

	<p>përkatës.</p> <p>Në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, rreth 15 nga lëndët që janë pjesë e këtij programi realizohen nga stafi akademik (PAE dhe PAK) i Departamentit të Lëndëve të Përgjithshme; rreth 6 nga lëndët realizohen nga stafi akademik i Departamentit të Lëndëve Profesionale; rreth 2 nga lëndët nga stafi i Qendrës për kërkime a studime ekonomike dhe juridike.</p> <p>Ky program studimi mbështetet akademikisht dhe nga stafi i njësive të tjera brenda institucionit, të cilat nuk janë pjesë e Fakultetit të Drejtësisë. Disa nga lëndët në këtë program studimi si p.sh., “Hyrje në Biznes”, “Sjellja Organizative”, “Komunikimi Profesional dhe Akademik”, “Hyrje në logjikën formale”, realizohen nga stafi i departamenteve të Fakultetit të Administrim Biznesit.</p> <p>Institucioni ka kapacitetet e duhura akademike për realizimin e objektivave dhe qëllimit të programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”.</p> <p><i>Aneksi 6; Aneksi 24</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ofrohet nga Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, i cili është një prej tre njësive të Fakultetit të Drejtësisë. Në këtë fakultet janë dhe dy njësi të tjera, stafi akademik i të cilave mbulon dhe disa nga lëndët e këtij programi studimi. Fusha e studimit në këtë program është e lidhur me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Drejtësisë (njësia kryesore).</p> <p><i>Aneksi 6</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është hartuar duke u bazuar në fushën e së drejtës publike (me kryesisht 7 lëndë), fushën e së drejtës penale (me kryesisht 3 lëndë) dhe fushën e së drejtës private, e cila është dhe fusha specifike e studimit (me kryesisht 9 lëndë). Fusha e përgjithshme dhe specifike e studimit lidhet me fushën e dy prej departamenteve të Fakultetit të Drejtësisë.</p> <p><i>Aneksi 7</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin,	Të gjitha njësitë akademike/kërkimore dhe njësitë e tjera (sekretaria

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>mësimore dhe zyra e çështjeve studentore) në Tirana Business University College (TBU) janë në funksion të realizimit të procesit mësimor. Ndërmjet njësisve ka një bashkëpunim në funksion të realizimit të procesit mësimor dhe çështje studentore.</p> <p>Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, si njësi bazë përgjegjëse për këtë program studimi, bën analizë në lidhje me realizimin e objektivave strategjike të zhvillimit të programit në aspektin e mësimdhënies, mësimnxënies, kualifikimit të stafit, etj. Në këtë analizë, njësi e evidenton dhe objektivat që lidhen me rritjen e numrit të studentëve të punësuar në profilin e fushës së diplomimit.</p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 38</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Objektivat e programit të studimit lidhen me ofrimin e njohurive bazë të avancuara të studentëve në fushën e lidhur me emërtimin e tij, si dhe me punësimin e studentëve në profilin e diplomimit. Për përmbushjen e objektivave të këtij programi, institucioni dhe njësi përkatëse përgjegjëse, ka lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit për realizimin e praktikave profesionale dhe krijimin e kontakteve për punësimin e studentëve. Marrëveshjet janë të përshtatshme për realizimin e komponentëve të procesit mësimor në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 32</i></p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësi përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me 120 partnerë nga fusha e biznesit, zyra ligjore, organizata që operojnë në fushën financiare, universitete publike, institucione vendore, institucione publike, etj.</p> <p>Në funksion të programit të studimit Bachelor “E drejtë Biznesi”, i cili është pjesë e programeve të studimit të ofruara nga Fakulteti i Drejtësisë, janë lidhur 10 marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Rezultatet dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit bëhen pjesë e Raporteve Vjetore të TBU, por njësi përkatëse (Departamenti i lëndëve të përgjithshme) nuk harton një raport vjetor që lidhet në mënyrë specifike me përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet apo partnerët e biznesit.</i></p> <p><i>Aneksi 32; Aneksi 35</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit që institucioni ka realizuar me partnerët që operojnë në sektorin private dhe publik janë në funksion të programeve të studimit dhe të komponentëve mësimor të programeve mësimore.</p> <p>Fakulteti i Drejtësisë ka marrëveshje bashkëpunimi që lidhen me zhvillimin e praktikave profesionale dhe me zhvillimin e trajnimeve përkatëse. Institucioni ka të dhëna në lidhje me institucionet partnere ku studentët kanë ndjekur praktikën profesionale si dhe të institucioneve ku studentët janë të punësuar (si p.sh., Banka Credins, Neptun Albania, OTP Bank Shqipëria, Bashkia e Tiranës, etj).</p> <p><i>Aneksi shtesë S.3 (gjatë vizitës)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime</p>	<p>Fakulteti i Drejtësisë, në bashkërendim me stafin akademik dhe</p>

profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	partnerët e biznesit, organizojnë trajnime (për studentët dhe të diplomuarit), aktivitete promovuese (përvjetori i Kodit Civil Shqiptar) etj. <i>Aneksi shtesë S.6 (gjatë vizitës); Minutat e takimit me stafin akademik dhe Zyrën e Çështjeve Studentore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është 180 ECTS gjithsej. Në rregulloren e programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” (neni 5), janë përcaktuar lëndët që lidhen me disipinën e formimit të përgjithshëm, formimit të karakterizuar, formimit ndërdisiplinor dhe formimit plotësues, sipas ndarjes në kreditet ECTS: 31 ECTS në kategorinë A; 97 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese B; 27 ECTS në kategorinë e lëndëve ndërdisiplinore dhe integruese si edhe lëndët me zgjedhje C; 19 ECTS në kategorinë e lëndëve plotësuese D; 6 ECTS detyrime përmbyllëse E. <i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i>
Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” (neni 3) përcakton qëllimet e këtij programi studimi, që lidhen me pajisjen e studentit me njohuri në fushën e së drejtës civile, administrative, tregtare dhe në fushën ekonomike dhe atë të komunikimit. <i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i>
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” përmban lëndë që mundësojnë për studentët aftësimin praktik të njohurive teorike të përftuara. Këto njohuri dhe shprehje të praktikës profesionale janë të përfshira në strukturën e programit të studimit. Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme ofron grupin e lëndëve më zgjedhje (kategoria C), në varësi të interesit akademik. Disa prej këtyre lëndëve ofrohen në vite të ndryshme akademike. Këto lëndë janë: “Shkrim dhe Arsyetim Ligjo” me 5 ECTS (kategoria C); “Hyryje në

	<p>Logjikën Formale” me 6 ECTS (kategoria C); “Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare” me 6 ECTS (kategoria C); “Avokatia Praktike e Biznesit” me 6 ECTS (kategoria C); “Përgjegjësia Civile dhe Penale e Biznesit” me 6 ECTS (kategoria C); “Gjykimi Administrativ” me 6 ECTS (kategoria B).</p> <p><i>Aneksi 14.1</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ofronë njohuri bazë dhe të avancuara në fushën e biznesit si dhe njohuri të nevojshme për zgjidhjen e problematikave në fushën përkatëse nëpërmjet lëndëve si p.sh., “E Drejta Civile”, “E Drejta e Shoqërive Tregtare”, “Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve Tregtare”, “Përgjegjësia Civile dhe Penale e Biznesit”.</p> <p><i>Aneksi 19</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ka një strukturë akademike të përshtatshme për këtë cikël studimi të ndarë në vite akademike/semestra, numrin e krediteve, orët e leksioneve/seminareve, kategorinë e lëndëve sipas viteve përkatëse (në kategoritë A, B, C, D, E). Në këtë program studimi, për shkak të specifikave në përzgjedhjen e lëndëve të kategorisë B dhe C, janë dhe shënimet përkatëse në lidhje me këto kategori lëndësh.</p> <p>Struktura akademike është e përcaktuar në rregulloren e programit (neni 4) dhe në aneksin bashkëlidhur kësaj rregullore.</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ka të përcaktuar kategoritë e lëndëve dhe veprimtarive formuese, sipas përcaktimeve në aktet ligjore. Këto kategori lëndësh, të ndara sipas fushës së veprimtarisë së tyre, janë të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit (neni 5). Në çdo vit akademik miratohet plani mësimor, në të cilin përcaktohen lëndët konkrete që ofrohen nga secila prej kategorive të lëndëve (kategoria A; B; C; D; E). Ky program studimi ka disa specifika në lidhje me numrin e lëndëve të ofruara nga tre prej kategorive të lëndëve (A; B; C). Nga kategoria A (lëndë bazë), për çdo vit akademik ofrohen vetëm 4 prej 5 lëndëve të renditura në planin mësimor që është pjesë e rregullores. Ky përcaktim bëhet çdo vit akademik nga departamenti i lëndëve të përgjithshme (njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi). Nga kategoria B (lëndë karakterizuese), përveç lëndëve që ofrohen në tre vitet akademike (10 lëndë), është dhe një grup lëndësh (5 lëndë) nga të cilat ofrohet çdo vit akademik vetëm 1 lëndë. Përcaktimi bëhet çdo vit akademik nga departamenti i lëndëve të përgjithshme. Nga kategoria C (lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje), përveç lëndëve që ofrohen në tre vitet akademike (3 lëndë – nga një në çdo vit), është dhe një grup lëndësh (10 lëndë) nga të cilat ofrohen çdo vit akademik vetëm 2 lëndë. Përcaktimi bëhet çdo vit akademik nga departamenti i lëndëve të përgjithshme. Kjo strukturë e planit mësimor është përshtatur me ndryshimet e kërkesave</p>

	të tregut të punës dhe kapacitetet akademike të njësisë bazë. <i>Aneksi 14.1</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme; Departamenti i Lëndëve Profesionale dhe Qendra për kërkime e studime ekonomike dhe juridike. Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është pjesë e Departamentit të Lëndëve të Përgjithshme. Kjo njësi përgjegjëse ka ngritur grupin e punës për hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm (Urdhër i Rektorit Nr. 9, datë 05.02.2020)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, drejtohet nga drejtuesi i departamentit të lëndëve të përgjithshme. Departamenti i lëndëve të përgjithshme është një prej tre njësive të Fakultetit të Drejtësisë. Detyrat e departamentit janë të përcaktuara në Statutin e institucionit (neni 23) dhe në rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të njësive bazë. Drejtuesi i departamentit të lëndëve të përgjithshme, përmes analizës vjetore të arritjes së objektivave të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësive profesionale të studentëve, informon drejtuesin e njësisë kryesore. <i>Aneksi 2; Aneksi 6; Aneksi 38</i>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	Drejtuesi i departamentit të lëndëve të përgjithshme, i cili është i emëruar dhe si koordinator i programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, është përgjegjës për rishikimin e shpërndarjes së krediteve sipas lëndëve përkatëse, strukturës së programit, rregullores së programit, ngarkesës së stafit akademik dhe miratimin e programeve të lëndëve për çdo vit akademik. Drejtuesi i njësisë propozon ndryshimet e mundshme të planit mësimor, të cilat miratohen me vendim të Senatit Akademik.
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	TBU, ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për përcaktimin e numrit të personelit akademik, me kohë të plotë, në njësitë bazë, në Kolegjin Universitar “Tirana Business University College”, e cila parashikon se, nëse TBU, për të paktën tre vite akademike, nuk ka më shumë se 600 studentë dhe përmbush kushtet e kodit të cilësisë të procesit mësimor, mund të mos plotësojë kushtet e pikës 4, të nenit 25 të Ligjit Nr. 80/2015, lidhur me përbërjen e

	<p>njësive bazë. Sipas kësaj marrëveshjeje, njësitë bazë, do të kenë të paktën nga një personel akademik, me kohë të plotë, që zotëron gradë shkencore apo titull akademik.</p> <p>Në Departamentin e Lëndëve të Përgjithshme, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi”, janë angazhuar si staf akademik PAE dhe PAK, në vitet akademike që prej akreditimit të parë, si në vijim:</p> <p>Viti akademik 19-20: 4 staf akademik me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 1 Prof. As., 2 Dr/PhD., dhe 1 Msc. dhe 7 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Dr., 1 Magjistër, dhe 5 Msc.</p> <p>Viti akademik 18-19: 2 staf akademik me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 1 PhD. dhe 1 Msc., dhe 7 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 2 Dr., 1 Magjistër, dhe 4 Msc.</p> <p>Viti akademik 17-18: 2 staf akademik me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 1 Prof. As. dhe 1 Msc. dhe 7 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. As., 1 Dr., 1 Magjistër, dhe 4 Msc.</p> <p>Viti akademik 16-17: 2 staf akademik me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 1 Prof. As., dhe 1 Msc. dhe 5 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. As., 2 Dr. dhe 2 Msc.</p> <p>Viti akademik 15-16: 2 staf akademik me kohë të plotë (PAE), me kualifikimin: 1 Prof. As., dhe 1 Msc., dhe 5 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. As., 2 Dr., dhe 2 Msc.</p> <p>Viti akademik 14-15: 1 staf akademik me kohë të plotë (PAE), me Msc. dhe 5 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. As., 3 Dr., dhe 1 Msc.</p> <p><i>Evidentohet se në të dhënat numerike të paraqitura në evidencën 23, ka disa mospërputhje në të dhënat e paraqitura në tabelën 1 dhe 2. Për pasqyrimin e të dhënave si më lart, GVJ, i është referuar të dhënave në tabelën 2.</i></p> <p><i>Aneksi 23, tabela 2; Aneksi 36; Aneksi shtesë 7</i></p>								
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme është njësia përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”. Kjo njësi, si pjesë e Fakultetit të Drejtësisë (<i>neni 3 i rregullores për organizimin e dhe funksionimin e njësisë bazë</i>), përmbush detyrimet ligjore dhe ato të përcaktuara në aktet e brendshme të institucionit (<i>neni 5 i rregullores së sipërcituar</i>), duke monitoruar procesin mësimor dhe duke hartuar raportin përkatës vjetor.</p> <p><i>Aneksi 6; Aneksi 38</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="590 1848 798 1915">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="798 1848 1029 1915">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1029 1848 1268 1915">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1268 1848 1540 1915">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="590 1915 798 1960"></td> <td data-bbox="798 1915 1029 1960"></td> <td data-bbox="1029 1915 1268 1960"></td> <td data-bbox="1268 1915 1540 1960" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, si njësia përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, ka informacionin e nevojshëm në lidhje me strukturën e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është i organizuar në lëndë (21 lëndë) dhe në zhvillimin e praktikës profesionale si lëndë që ofrohe në çdo vit akademik me 15 ECTS.</p> <p>Praktika profesionale/seminar special, sipas rregullores për praktikën mësimore (neni 4) zhvillohet në formën e seminareve speciale të organizuara nga institucioni si dhe pranë studiove ligjore, avokatore, institucione publike apo institucioneve të propozuara nga vetë studenti. Vlerësimi i praktikës bëhet në bazë të raportit të praktikës/projekt menaxhimit të hartuar nga studenti (neni 6 i rregullores së praktikës mësimore dhe neni 25 të rregullores së programeve të studimit dhe procesit mësimor).</p> <p>Në bazë të nenit 5 të rregullores për praktikën, drejtuesi i praktikës profesionale/seminar special përcaktohet nga dekani.</p> <p><i>Aneksi 18; Aneksi 25; Aneksi shtesë 2</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është i organizuar në tre vite akademike dhe në gjashtë semestra. Secili vit akademik mund të ketë një numër të njëjtë kreditesh (60 ECTS), sipas Aneksit A bashkëlidhur rregullores së programit të studimit. <i>Studentët kanë fituar në vitin e tretë akademik 60 ECTS të detyrueshme, edhe pse disa studentë kanë fituar më shumë kredite, pasi kanë pasur mundësi të marrin edhe lëndë mbi këtë numër kreditesh (pa pagesë shtesë). Gjithsesi, në planin mësimor të vitit akademik 2019-2020, ky fakt nuk është pasqyruar saktësisht.</i></p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” janë të përcaktuara orët në auditor në formën e leksioneve dhe seminareve. Bazuar në rregulloren e programit të studimit (neni 4) në këtë program studimi duhet të realizohen të paktën 4.500 orë nga të cilat 1.560 orë studimi në auditor dhe rreth 2.940 orë studimi individuale.</p> <p>Sipas planit mësimor të vitit 2019-2020, në vitin e parë akademik janë 540 orë në auditor dhe 950 orë punë individuale e studentit; në vitin e dytë janë gjithsej 570 orë në auditor dhe 930 orë punë individuale; në vitin e tretë janë 645 orë në auditor dhe 1280 orë punë individuale e studentit.</p> <p>Në çdo program lënde janë përcaktuar orët e detyrueshme të</p>

	<p>frekuentimit dhe format e vlerësimit të dijeve. Format e vlerësimit të dijeve janë: pjesëmarja aktive në auditor, detyra kursi, teste përgjatë semestrit, provim përfundimtar. Forma e kontrollit të dijeve nuk është e njëjtë në të gjitha lëndët. Në të gjitha lëndët aplikohet pjesëmarja aktive në auditor (në masën 10 % deri në 15 %). Në disa nga lëndët aplikohen teste (dy) përgjatë zhvillimit të procesit (p.sh., “E Drejta Publike”, “Procedura Civile”, etj.), në disa lëndë aplikohen detyra kursi në masën 30 % dhe provimi përfundimtar në masën 60 % (p.sh., “E Drejta Civile”, “E Drejta Penale”).</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1; Aneksi 19</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ka përcaktuar qëllimin dhe objektivat e programit (neni 3), strukturën e programit (neni 5), organizimin e planit mësimor sipas aneksit A (neni 7), kriteret dhe procedurat e pranimit (neni 11), kreditet dhe përlllogaritjen e tyre sipas sistemit të krediteve evropiane ECTS (neni 13). Procedura e transferimit është parashikuar në nenin 32 të rregullores për programet e studimit dhe procesin mësimor. Në rregulloren për programet e studimit dhe procesin mësimor janë përcaktuar dhe kriteret e përgjithshme dhe procedura e pranimit për studentët e ciklit Bachelor dhe master (neni 2).</p> <p>Dekani i Fakultetit të Drejtësisë i propozon Senatit Akademik kriteret për pranimin e studentëve për çdo vit akademik.</p> <p><i>Aneksi 5; Aneksi 7; Aneksi S.1 (gjatë vizitës); Aneksi S.2 (gjatë vizitës)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Çdo lëndë në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me: numrin e krediteve, orët e punës në auditor të ndara në formën e leksioneve dhe seminareve, titullarin e lëndës, vitin akademik, qëllimin dhe objektivat e lëndës, temat përgjatë javëve akademike me literaturën përkatëse, format e vlerësimit të dijeve dhe literaturën të ndarë në të detyrueshme dhe të rekomanduar. Në disa nga lëndët e programit titullari/lektori harton dhe leksionet përkatëse për çdo temë, të cilat janë pjesë e literaturës që i vihet studentit në përdorim (p.sh., në lëndët “Procedura Civile”, “E Drejta Fiskale”, “E Drejta e Bashkimit Evropian”, etj).</p> <p><i>Aneksi 19</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Neni 8 i rregullores së programit të studimit përcakton fleksibilitet në lidhje me strukturën e planit mësimor. Sipas kësaj rregulloreje, çdo vit akademik, njësia bazë bën propozimet për miratimin e planit mësimor me ndryshimet përkatëse. Plani mësimor miratohet nga dekani dhe rektori. Ndryshimet në planin mësimor lidhen kryesisht me ofrimin e lëndëve në kategoritë B dhe C. <i>Studentët kanë fituar në vitin e tretë akademik 60 ECTS të detyrueshme, edhe pse disa studentë kanë fituar më shumë kredite, pasi kanë pasur mundësi të marrin edhe lëndë mbi këtë numër kreditesh (pa pagesë shtesë). Gjithsesi, në planin mësimor të vitit akademik 2019-2020, ky fakt nuk është pasqyruar saktësisht.</i></p> <p>Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi (departamenti i</p>


	<p>lëndëve të përgjithshme) bën një analizë të realizimit të objektivave strategjike të zhvillimit të programit në aspektin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke evidentuar dhe arrijet e studentëve.</p> <p>Plani mësimor i rishikuar dhe përmirësuar miratohet nga strukturat përkatëse. <i>Ndryshimet e realizuara në planin mësimor të vitit akademik 2019-2020, në masën mbi 20 %, janë miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 3, datë 20.06.2019 “Mbi miratimin e rregulloreve të programeve të studimit në zbatim të VKM-së “Për elementët e programeve të studimit”</i>”. Për këto ndryshime Institucioni ka njoftuar MASR me shkresën Nr. 43 Prot., datë 18.10.2019 dhe MASR ka konfirmuar marrjen e dijeni për ndryshimet me shkresën me Nr. 9579/1 Prot., datë 05.11.2019.</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1; Aneksi 38; Aneksi shtesë 7; Tabelat përmbledhëse, tabela 11</i></p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënies dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është i organizuar në tre vite akademike (gjashtë semestra) dhe në jo më pak se 180 ECTS. Në rregulloren e këtij programi studimi (neni 4) është parashikuar dhe ngarkesa totale e orëve në auditor për tre vitet akademike. Kjo ngarkesë akademike në auditor është përcaktuar të jetë jo më pak se 4.500 orë, nga të cilat 1.560 janë orë pune në auditor dhe 2.940 janë orë pune individuale e studentit. Në nenin 8 të kësaj rregulloreje është parashikuar dhe një fleksibilitet në lidhje me strukturën e planeve mësimore. Sipas këtij rregullimi, plani mësimor mund të ketë një numër më të madh se 180 ECTS. Në Aneksin A të kësaj rregulloreje plani mësimor është parashikuar me 180 ECTS dhe me 60 ECTS në çdo vit akademik. Sipas RVB-së (fq.14), çdo vit akademik studentëve ju ofrohen lëndë që në total janë jo më pak se 60 ECTS. Ngarkesa javore e punës së studentit në auditor është 20 orë (sipas RVB-së, fq.14).</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i></p>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është në përshtatje me përmbajtjen e lëndëve që janë pjesë e planit mësimor. Në këtë program studimi janë gjithsej 21 lëndë, pa përfshirë praktikën profesionale/seminarin special që ka gjithsej 15 ECTS (në tre vitet akademike). Praktika profesionale është e parashikuar në çdo vit akademik me numër të caktuar kreditesh (3 ECTS në vitin e parë, 5 ECTS në vitin e dytë dhe 7 ECTS në vitin e tretë). Praktika</p>

	<p>profesionale/seminari special mundëson një aplikim në praktikë të njohurive të fituara.</p> <p>Institucioni, në funksion të mundësisë së punësimit të studentëve gjatë viteve të studimit, ofron zhvillimin e procesit mësimor në dy fasho orare (sipas RVB-së fq.14).</p> <p>Institucioni, ka të dhëna për numrin e të punësuarve gjatë viteve të studimit.</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1; Aneksi 29; Aneksi shtesë S.3 (gjatë vizitës)</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” me jo më pak së 180 ECTS është i organizuar në tre vite akademik (gjashtë semestra). Shpërndarja e lëndëve sipas kategorive është bërë në të tre vitet akademike përkatësisht (<i>sipas ankesit të rregullores së programit</i>):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. në vitin e parë akademik: katër lëndë të formimit bazë me 31 ECTS (kategoria A), tre lëndë të formimit karakterizues me 17 ECTS (kategoria B), një lëndë ndërdisiplinore me 5 ECTS (kategoria C) dhe një lëndë plotësuese (kategoria D) me 5 ECTS; 2. në vitin e dytë akademik: shtatë lëndë të formimit karakterizuaes me 50 ECTS (kategoria B), një lëndë ndërdisiplinore me 5 ECTS (kategoria C) dhe një lëndë plotësuese (kategoria D) me 5 ECTS; 3. në vitin e tretë akademik: pesë lëndë të formimit karakterizues me 30 ECTS (kategoria B), tre lëndë ndërdisiplinore me 17 ECTS (kategoria C); një lëndë plotësuese (kategoria D) me 7 ECTS dhe diploma/provimi i përgjithshëm (kategoria E) me 6 ECTS. <p>Kjo shpërndarje e lëndëve dhe e numrit të krediteve ndër vitet akademike mundëson kryesisht ofrimin e njohurive bazë përgjatë vitit të parë akademik, në të cilin janë të gjitha lëndët e kategorisë A, ndërsa në vitet e tjera ofrohen kryesisht njohuri karakterizuese të programit. Në të tre vitet ofrohen njohuri në lëndë ndërdisiplinore dhe plotësuese.</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, me jo më pak se 60 ECTS për çdo vit akademik (<i>sipas RVB-së fq.14</i>), ka në përmbajtjen e tij rreth katër lëndë të mirëfillta teorike dhe pjesën tjetër të lëndëve i ka të lidhura me formimin teoriko-praktik.</p> <p>Ky program studimi synon të ofrojë (neni 3/objektivi i katërt i rregullores së programit) një formim sa më praktik të studentëve në fushën e të drejtës private dhe tregtare dhe andaj shumica e lëndëve janë me fokus në këtë fushë të së drejtës.</p> <p>Përmbajtja e programit është në përputhje me qëllimin e dhe objektivat e studimit.</p> <p><i>Aneksi 7; Aneksi 14.1</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” përmban lëndë të grupura sipas pesë kategorive kryesore të formimit (A, B, C, D, dhe E).</p>



<p>teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Numrin më të madh të lëndëve e zënë lëndët karakterizuese të programit dhe të profilit (kategori B) me 11 lëndë. Ky numër lëndësh mundëson një formim më të profilizuar dhe më të lidhur me tregun e punës. Njohuritë e ofruara në këto lëndë rrisin mundësitë e punësimit në fushën përkatëse të lidhur me të drejtën e biznesit. Fusha e punësimit për studentët është kryesisht e lidhur me emërtimin e vetë programit. <i>Aneksi 14.1; Aneksi 32; Aneksi shtesë S.3 (gjatë vizitës)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” përditësohen nga ana e titullarëve përkatës në funksion të përfshirjes së temave apo literaturës bazë apo suplementare të përditësuar (si vendime gjyqësore, etj). Programet e lëndëve të përditësuara miratohen nga drejtuesi i njësisë çdo vit akademik dhe ato janë pjesë dhe e analizës vjetore të departamentit. <i>Aneksi 19; Aneksi 38</i></p>
<p>Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” ka si objektiva kryesor të tij (<i>neni 3/objektivi i pestë dhe i gjashtë, tek rregullorja e programit të studimit</i>): ofrimin e njohurive të përshtatshme për ushtrimin e profesionit të juristit në sektorin privat të biznesit; punësimin e studentëve përpara përfundimit të studimeve në zyra juridike apo në pozicione pune si banka, kompani biznesi. Përbajtja e programit të studimit, përmes lëndëve si: “Hyrje në Biznes”, “Sjellje Organizative”, “Siguria në Biznes dhe Shërbimet e Sigurisë”, “Komunikimi profesional dhe akademik”, “E Drejta e Shoqërive Tregtare”, “E Drejta Private”, “Pronësia Intelektuale”, “Zgjidhja Alternative e Mosmarrëveshjeve tregtare”, “Avokatia Praktike e Biznesit” etj, ofrojnë mundësi praktike njohurish për në tregun e punës <i>Aneksi 7; Aneksi 19</i></p>
<p>Kriteri 8. Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ka si objektivi të tij dhe vijimin e studimeve në nivelin master (<i>neni 3/objektivi i katërt tek rregullorja e programit të studimit</i>). Ky objekt mundësohet përmes ofrimit në këtë program studimi të lëndëve që mundësojnë njohuri të avancuara për studentët si p.sh., lëndët: “Gjykimi administrativ”, “Procedura Civile”, “Procedura Penale” etj. <i>Aneksi 7; Aneksi 19</i></p>
<p>Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Njësia përkatëse përgjegjëse për këtë program studimi bën rishikimin e planit mësimor duke ofruar lënda nga kategoria C (lëndë me zgjidhje) në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Plani mësimor i rishikuar miratohet nga strukturat përkatëse akademike, në bazë të propozimeve të njësisë bazë. Institucioni ka kryer “Studimin për tregun e punës pas daljes studentëve”, Janar 2020, sipas të cilit rezulton që rreth 96 % e të diplomuarve në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” janë të punësuar dhe rreth 70 % e tyre në përputhje me fushën e studimit. Zyra e karrierës dhe punësimit e ka hartuar këtë dokument mbi bazën e</p>




	<p>të dhënave të grumbulluara nga anketimet e të diplomuarve dhe opinionet e përfaqësuesve të kompanive/subjekteve partnere. Nëpërmjet këtij lloj studimi tregu (fq.3) rekomandohet nga partnerët e tregut të punës dhe kuotat e pranimit për vitin pasardhës.</p> <p>Zyra për Çështjet Studentore mban kontakte të drejtpërdrejta me studentët e diplomuar (për shkak dhe të numrit të vogël të studentëve) në lidhje me mundësinë e tyre për të mbështetur në tregun e punës studentët që janë në proces diplomimi.</p> <p><i>Aneksi 17; Aneksi shtesë 7; Minutat e takimit me Zyrën për Çështjet Studentore.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik (PAE dhe PAK) ka kualifikimin e duhur akademik dhe shkencor dhe është në përputhje me përmbajtjen e lëndëve të programit të studimit “E Drejtë Biznesi”. Përbërja numerike dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program, që prej akreditimit të parë, pasqyrohet në vijim:</p> <p>Në vitin akademik 2019-2020 janë angazhuar: 14 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 3 Prof. As., 4 Dr/PhD., dhe 7 Msc., dhe 9 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Dr/PhD., 1 Magjistër dhe 4 Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar: 15 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 4 Prof. As., 2 Dr/PhD., dhe 9 Msc., dhe 10 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 2 Dr/PhD., 3 Magjistër dhe 3 Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar: 9 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. As., 1 Dr/PhD., dhe 6 Msc., dhe 12 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 2 Dr/PhD., 2 Magjistër dhe 6 Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar: 7 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. As dhe 5 Msc., dhe 14 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 3 Dr/PhD., 1 Magjistër dhe 8 Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar: 8 staf akademik efektiv (PAE), me kualifikimin: 2 Prof. As., 1 Dr/PhD, dhe 5 Msc., dhe 9 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 3 Dr/PhD., 1 Magjistër dhe 1 Msc.</p> <p>Në vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar: 4 staf akademik efektiv</p>

	<p>(PAE), me kualifikimin: 1 Dr/PhD. Dhe 3 Msc., dhe 5 staf akademik me kontratë (PAK), me kualifikimin: 1 Prof. Dr., 2 Prof. As., 1 Dr/PhD., dhe 1 Msc.</p> <p>Sipas nenit 59, pika 3, LAL 80/2015: “Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i Psociuar”.</p> <p>Në këtë program studimi, jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve mbajnë titullin sipas përcaktimeve në aktet ligjore përkatëse.</p> <p>Në vitin akademik 19-20, stafi PAE mbulon 76 % të ngarkesës mësimore dhe stafi PAK mbulon 24 %.</p> <p>Lidhur me numrin e lëndëve/orëve që mbulon stafi i angazhuar në këtë program studimi, për vitin akademik 2019-2020, për stafin PAE, varion nga 1-5 lëndë/module dhe nga 60-225 orë mësimore, ndërsa për stafin PAK, varion nga 1-3 lëndë dhe nga 15-90 orë mësimore.</p> <p>Në vitin akademik 18-19, stafi PAE mbulon 73.5 % të ngarkesës mësimore dhe stafi PAK mbulon 26.5 %.</p> <p>Në vitin akademik 17-18, stafi PAE mbulon 67.5 % të ngarkesës mësimore dhe stafi PAK mbulon 32.5 %.</p> <p><i>Duhet evidentuar që në të dhënat e paraqitura nga IAL ka disa mospërputhje, të cilat kanë vështirësuar konstatimet e GVJ sa më lart. GVJ, për këto të dhëna, i është referuar anekseve 24 dhe 25.</i></p> <p><i>Aneksi 19; Aneksi 24, tabela 6 dhe 7; Aneksi 25</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik (PAE dhe PAK) ka eksperiencë akademike dhe profesionale në fushën e drejtësisë. Stafi akademik PAK është pjesë e organeve të drejtësisë (Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë), institucioneve të lartë të pavarura (Autoriteti i Konkurrencës), organeve të pushtetit ekzekutiv, profesioneve të pavarura dhe zyrave juridike. Eksperienca e stafit PAK është në funksion të programeve të lëndëve përkatëse.</p> <p><i>Aneksi 20; Aneksi 24</i></p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik (PAE dhe PAK) i angazhuar ndër vite në këtë program studimi ka kualifikimin akademik dhe shkencor në përshtatje me lëndët e planit mësimor. Lëndët që kërkojnë njohuri të lidhura me praktikën në fushën e së drejtës, lektohen nga stafi që ka eksperiencën e duhur profesionale si p.sh. lëndët: “E Drejta Civile”, “E Drejta Kontraktore dhe Lidhja e Kontratës”, “Procedura Civile”, “E Drejta Kushtetuese”, “E Drejta e Bashkimit Europian”, etj.</p> <p><i>Aneksi 24</i></p>



<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Tirana Business University College (TBU) ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional dhe në nivelin e njësive kryesore. Rregullorja “Për praktikat mësimore” përcakton modalitetet e zhvillimit të praktikave si: kohën e zhvillimit të praktikës, organizimin e praktikës, detyrat e pedagogut përgjegjës të praktikës, detyrat e studentit për përmbushjen e detyrimeve që lidhen me praktikën profesionale.</p> <p><i>Aneksi 38; Aneksi shtesë 18</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Tirana Business University College (TBU), në bazë të mënyrës së organizimit të njësive kryesore/bazë dhe të njësive të tjera ndihmëse, (<i>Statuti</i>), siguron harmonizimin e komponentëve akademikë dhe administrativ të procesit mësimor.</p> <p>Realizimi i procesit mësimor në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, sigurohet përmes bashkëpunimit të tre njësive të Fakultetit të Drejtësisë, stafi akademik i të cilëve përmbush detyrat në funksion të procesit mësimor dhe të aktiviteteve ekstra kurrikulare të zhvilluara.</p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 24</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>TBU ka miratuar Udhëzuesin “Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies”. Udhëzuesi është hartuar në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor në TBU. Përmes këtij dokumenti, institucioni, kërkon të krijojë një klimë bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të procesit akademik (stafit dhe studentëve).</p> <p><i>Aneksi 39</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike</p>	<p>Monitorimi i aftësive mësimdhënëse dhe inovative të stafit akademik bëhet në mënyrë periodike nga njësia bazë dhe ajo kryesore, si dhe në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	mënyrë periodike, përgjatë vitit akademik nga NJSBC. Metodave dhe instrumentet e përdorura janë vëzhgimi në auditor i leksioneve/seminareve, si dhe pyetësi me studentët, i cili realizohet për çdo lëndë, në fund të çdo semestri/viti akademik.			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Sipas rregullores së NJSBC, për çdo vit akademik, njësi përgatit Planin e Punës, i cili miratohet nga Senati Akademik, por, në dokumentacionin e përcjellë në kuadër të këtij vlerësimi, nuk evidentohet të jetë hartuar një plan i tillë pune nga ana e njësisë.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e anketimit deklarohet se bëhen pjesë e analizës vjetore të njësisë bazë dhe NJSBC, megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet se: <i>mungon një analizë/relacion semestral i realizuar nga NJSBC për rezultatet e pyetësorit të studentëve, mangësi e cila reflektohet edhe në raportin vjetor të hartuar prej tij; në raportin vjetor të hartuar nga njësi mungojnë rezultatet e pritshme dhe masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë nga ana e strukturave përgjegjëse; mangësitë e mësipërme reflektohen edhe në analizën e njësisë bazë dhe raportin vjetor të institucionit.</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.	Gjithashtu, GVJ nuk evidenton raporte vlerësuese për përmirësimet të problematikave të mëparshme, qoftë të programit apo institucionit. Rekomandohet që raporti vjetor të përmbajë dhe aspekte të problematikave të konstatuara përgjatë vitit akademik. GVJ konstaton se studentët përfshihen në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve nëpërmjet anketave dhe pyetësorëve, në përputhje me aktet rregullatore të TBU, si dhe gjithashtu kanë të drejtën e paraqitjes së mendimit të tyre lidhur me përmirësimin e procesit mësimor. Sugjerohet që keto anketa të bëhen pjesë e analizës periodike të mbarëvajtjes së programit të studimit dhe përfundimet t'ju bëhen të ditura dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2


Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë	Në programin e studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” mësimdhënia ushtrohet në formën e leksioneve dhe seminareve. Në asnjë nga lëndët e këtij programi nuk janë të përfshira ushtrimet apo laboratorët. Praktika profesionale është lëndë që zhvillohet në tre vite akademike (në vitin e


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>parë/semestri i dytë; në vitin e dytë/semestri i katërt dhe në vitin e tretë/semestri i gjashtë). Kjo lëndë, sipas rregullores përkatëse, zhvillohet në formën e seminareve speciale apo praktikës së kryer pranë institucioneve përkatëse (<i>Link http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/aktivitete-ne-tbu</i>).</p> <p>Për zhvillimin e praktikave pranë institucioneve apo kompanive të biznesit, institucioni, në bashkëpunim me njësinë përkatëse, lidh marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p><i>Aneksi 14.1; Aneksi shtesë 18; Aneksi 32; Aneksi 34; Aneksi shtesë S.3 (gjatë vizitës)</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Stafi akademik (PAE dhe PAK) i angazhuar në realizimin e programit të studimit “E Drejtë Biznesi”, rishikon dhe përmirëson programet e lëndëve në varësi të ndryshimeve ligjore në fushën e jurisprudencës. Këto përmirësime lidhen dhe me metodat e mësimdhënies, duke përfshirë në programet e lëndëve, tema që lidhen me praktikën gjyqësore, të cilat nxisin metodën interaktive të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Përmirësimi i programeve të lëndëve realizohet edhe përmes interesit të studentëve në tema specifike.</p> <p><i>Aneksi 19; Minutat e takimit me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një udhëzues “Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies”. Ky dokument synon të standardizojë procesin e kualifikimit dhe profesionalizmit të mësimdhënies, përmes disa modeleve. Dokumenti është hartuar në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies me fokus tek studentët. Institucioni synon monitorimin e procesit të mësimnxënies, përmes aplikimit të instrumentave të ndryshëm të vlerësimit.</p> <p>Stafi akademik i programit të studimit “E Drejtë Biznesi” realizon komponentët e procesit të mësimdhënies përmes leksioneve dhe seminareve. Stafi akademik përdor metodatat interaktive të mësimdhënies në lëndët që kanë në fokus të tyre praktikat gjyqësore si p.sh., në lëndët “E Drejta Civile”, “E Drejta Kushtetuese”, “Procedura Civile”, “Procedura Penale”, etj.</p> <p><i>Aneksi 19; Aneksi 39</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit “E Drejtë Biznesi”, ka eksperiencën e duhur në fushat përkatëse të së drejtës. Kjo eksperiencë i mundëson atyre që përdorin metodat më të përshtatshme për transmetimin e dijeve tek studentët dhe për të nxitur tek ata të analizuarit kritik.</p> <p>Stafi akademik (PAE dhe PAK), me përvojë profesionale në institucionet publike dhe gjyqësore, ofron për studentët eksperiencat që lidhen me praktikën profesionalw. Ky proces realizohet përmes metodave praktike të mësimdhënies.</p> <p><i>Aneksi 20; Aneksi 24; Minutat e takimit me stafin akademik dhe studentët e programit</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në</p>	<p>Në TBU mund të realizohen dhe forma të individualizuara të mësimdhënies me një grup studentësh (jo më shumë se 8), sipas nenit 12 të rregullores për programet e studimit dhe procesin mësimor (<i>Aneksi</i></p>



<p>këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>5). Aplikimi i kësaj forme të mësimdhënies ofrohet nga institucioni për rastet kur studentët duan të avancojnë në marrjen e njohurive apo kur për shkak të veprimtarive profesionale të tyre kërkojnë të jenë pjesë e grupeve të tilla. Për realizimin e një praktike të tillë të zhvillimit të individualizuar të procesit mësimor, vendimi merret nga Rektori me propozimin e njëjësive përkatëse. Kjo formë e mësimdhënies kërkon të inkurajojë studentët me performancë të lartë akademike.</p> <p>Drejtuesi i departamentit të lëndëve të përgjithshme, si koordinatori i programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, harton raportin vjetor, në lidhje me realizimin e objektivave të programit të studimit, duke evidentuar dhe arritjet dhe rezultatet e pritshme.</p> <p><i>GVJ rekomandon që në raportin vjetor të departamentit, të përfshihen dhe sugjerimet apo rekomandimet e studentëve në lidhje me komponentët specifik të procesit mësimor. Këto rekomandime/sugjerime të studentëve, mund të merren nga pyetësorët e tyre, ose dhe nga takimet me fokus grupet që departamenti mund të realizojë me studentët në funksion të përmirësimit të procesit mësimor.</i></p> <p><i>Aneksi 5 Aneksi 36; Aneksi 38</i></p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Në bazë të “Rregullores për programet e studimit dhe procesin mësimor” (neni 11), mësimdhënia realizohet në grupe leksionesh me jo më shumë se 50 studentë dhe në grupe seminaresh në jo më shumë se 20 studentë. Numri i vogël i studentëve për grupe mësimore mundëson për stafin akademik realizimin e metodave interaktive të komunikimit. Stafi akademik nxit dhe inkurajon studentët drejt diskutimeve akademike në lidhje me aktualitet në fushën e së drejtës.</p> <p><i>Aneksi 5; Minutat e takimit me studentët e programit</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies të aplikuara në TBU dhe në programin e studimit “E Drejtë Biznesi” kanë në qendër studentin. Përmes procesit të mësimdhënies synohet ofrimi i dijeve të qëndrueshme. Studentët nxiten të jenë pjesë aktive e procesit të mësimdhënies përmes debateve akademike, analizimit të rasteve nga praktika gjyqësore. Temat që inkurajojnë autonominë e studentit janë pjesë e programeve në disa prej lëndëve të planit mësimor.</p> <p><i>Aneksi 19</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3


Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e</p>	<p>Institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



<p>shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>zhvillimin e procesit mësimor, e evidentuar edhe nga vizita në ambientet e institucionit. Vlen për tu shënuar që Institucioni garanton në mënyrë efektive edhe aksesin për personat me aftësi të kufizuara duke qenë i pajisur me rampë hyrëse dhe ashensorë.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Sallat dhe klasat e Institucionit janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit mjaftueshëm për të garantuar mësimdhënie përmes këtyre teknologjive. Institucioni garanton akses në mënyrë të vazhdueshme në internet përmes wifi. Edhe gjatë vizitës në Institucion, u mundësia realizimi i një prej takimeve të agjendës me stafin përgjegjës online, pa probleme teknike.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Aneksi 42; Aneksi 47; Aneksi shtesë 08; Vizita në IAL, vëzhgimi i ambienteve Duke pasur parasysh që vetë programi i studimit nuk kërkon një teknologji të avancuar për zhvillimin e tij, nevojat laboratorike dhe të sallës së internetit Institucioni i plotëson në sallën e bibliotekës, e cila është e pajisur gjerësisht me mjetet e nevojshme të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Institucioni ka hartuar një Udhëzues për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, e cila i shërben kualifikimit të mëtejshëm profesional të stafit akademik, si dhe një Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Nga takimi në institucion u evidentua që infrastruktura teknologjike lejon zhvillimin e mësimdhënies me mjete informatike dhe gjithashtu edhe nga takimi me studentët u evidentua fakti i përdorimit me sukses i teknologjisë së informacionit për zhvillimin e leksioneve në kohën e pandemisë.</p> <p><i>Aneksi 46; Aneksi 48</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën mësimore, e cila ka ambiente të përshtatshme, madhësi salle, kompjutera, dritë natyrore, mjete ngrohje-ftohje si dhe një person të dedikuar për mbarëvajtjen e punës në të. Aksesin në bibliotekë është i garantuar në mënyrë të barabartë si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur fizikisht me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj si edhe me revista shkencore. Ajo mbulon një pjesë të madhe të literaturës së kërkuar për mbulimin e moduleve të veprimtarisë mësimore. <i>Gjithsesi, evidentohet mungesa e disa teksteve të nevojshme për programin e studimit dhe një numër i vogël i kopjeve të teksteve të disponueshme. GVJ rekomandon përfshirjen në bibliotekë të të gjitha teksteve të parashikuara në programin e studimit dhe shtimin e numrit të kopjeve për tekst.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Institucioni garanton akses pa pagesë në bibliotekën online EBSCO, në të cilën ofrohen mbi 40.000 tituj (Business Source Complete Database).</p>



	<p>Gjatë vizitës në institucion u bënë disa prova nga GVJ për aksesin në bibliotekën on line për tekste të huaja në gjuhën italiane dhe angleze dhe rezultoi që biblioteka ishte funksionale dhe ofronte gamë të gjerë tekstesh të ndryshme juridike në gjuhë të huaj.</p> <p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera në sasi të konsiderueshme dhe me akses në internet, duke krijuar mundësinë e shfrytëzimit pa kufizime nga ana e studentëve.</p> <p><i>Ndryshe nga sa referohet në RVB (fq. 33) nuk rezulton që të ketë një plan të detajuar për Bibliotekën e Institucionit për shtimin e zërave të bibliotekës apo përditësimin e fondit ekzistues. Paçka se kjo parashikohet në planin për Bibliotekën, nuk u vu në dispozicion një procedurë e detajuar në lidhje me pikën 1 të Urdhërit të Rektorit Nr. 15, datë 18/10/2019.</i></p> <p>Biblioteka e Institucionit mund të aksesohet në orarin 09:00-21:00, orar ky i përshtatshëm për shfrytëzimin e saj në mënyrë të barabartë dhe pa kufizim nga të gjithë studentët dhe stafi akademik.</p> <p><i>Aneksi 42; Aneksi 45; Aneksi 46; Aneksi shtesë 16; Vizita në IAL, vëzhgimi i ambjentëve</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Sikurse përmendur edhe më sipër, natyra e programit të studimit nuk kërkon një teknologji të avancuar për zhvillimin e tij, ndaj nevojat laboratorike dhe të sallës së internetit, Institucioni i plotëson në sallën e bibliotekës, e cila është e pajisur gjerësisht me mjetet e nevojshme të teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>TBU ka implementuar një sistem online interaktiv (Sistemi i Menaxhimit të Studentëve) që mundëson lehtësimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit. Ky sistem i shërben studentëve të aksesojnë notat, të komunikojnë me stafin, të lexojnë materiale mësimore, të informohen për ecurinë e pagesave, të marrin informacion lidhur me eventet e TBU apo njoftime të ndryshme, etj. Sistemi gjithashtu i shërben stafit akademik për të depozituar materiale ndihmëse e për të komunikuar me studentët dhe strukturat e tjera të TBU. Stafi drejtues i TBU dhe zyrat e tjera ndihmëse (sekretari, marketing, financë) mund të monitorojnë aspekte të caktuara të lidhura me veprimtaritë respektive. Gjithashtu, Institucioni shfrytëzon edhe aplikacione si Google Drive, Dropbox apo Google Classroom, ku pedagogë të caktuar ngarkojnë materialet e tyre lëndore dhe komunikojnë në mënyrë interaktive me studentët. Stafi akademik, administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë email, të identifikuar nga TBU (emër.mbiemër@tbu.edu.al).</p> <p><i>Aneksi 46</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Rregullorja e programeve të studimit dhe procesit mësimor (neni 27) ka</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e</p>	



<p>temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>përcaktuar kriteret e diplomimit të studentëve. Mbrojtja e diplomës realizohet nëpërmjet provimit përfundimtar të formimit ose një punimi diplome. Kriteret për diplomimin e studentëve të ciklit të parë, përmes një punimi diplome janë të lidhura me notën mesatare (mbi 7). Për provimin përfundimtar ngrihet nga dekani një komision me tre anëtarë. Në programin e studimit “E Drejtë Biznesi”, diplomimi/provimi i përgjithshëm përfundimtar (kategoria E) ka 6 ECTS.</p> <p>Institucioni ka hartuar dhe Udhëzuesin “Për përgatitjen e temës së diplomës”. Ky udhëzues përcakton mënyrën e përzgjedhjes së tematikës së temës së diplomës, formën e organizimit të temës së diplomës, numrin e faqeve për të gjitha programet e studimit, mënyrën e përdorimit të referencave si dhe procedurën e mbrojtjes së temës.</p> <p><i>Aneksi 5; Aneksi shtesë 1; Aneksi shtesë 13; Aneksi shtesë 14</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni (TBU) ka një strukturë akademike në funksion të programeve të studimit që ofron dhe proceseve akademike dhe administrative. Të gjitha njësitë bashkëpunojnë për realizimin e komponentëve të procesit mësimor dhe të rritjes së cilësisë të mësimdhënies.</p> <p>Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, si njësi bazë përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi”, kryen raport periodik të analizës së punës dhe arritjeve të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti përgjegjës për këtë program studimi harton dhe planin e aktiviteteve për çdo vit akademik, në bazë të së cilit përcaktohen objektivat dhe instrumentet e përbushjes së tyre.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni (TBU) ka miratuar Udhëzuesin “Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” në bazë të të cilit janë përcaktuar metodat në lidhje me monitorimin e proceseve mësimore (vlerësimi të mësimnxënies), metodat inovative në lidhje me proceset mësimore dhe ato të kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Lëndëve të Përgjithshme, si njësi përgjegjëse për këtë program studimi, analizon në mënyrë periodike kualifikimin dhe rritjet e kapaciteteve të personelit akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” është në koherencë me zhvillimet në fushën përkatëse të studimit, duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme programet mësimore (sipas RVB-</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423


Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



metodave të reja.	<i>së fq. 23 dhe Aneksi 19).</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Institucioni harton dhe pyetësorë drejtuar stafit akademik për përmirësimin e proceseve të punës së institucionit dhe proceseve mësimore. Për mbarëvajtjen e proceseve mësimore është hartuar dhe rregullorja përkatëse. Udhëzuesi “Për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies” informon dhe orienton stafin akademik në drejtim të përdorimit dhe aplikimit të metodave inovative në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor. <i>Aneksi 2, Aneksi 5; Aneksi 38; Aneksi shtesë 22; Aneksi 39; Aneksi 41; Aneksi shtesë 10</i>			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Në rregulloren “Për programet e studimit dhe procesin mësimor” janë të përcaktuara metodat e mësimdhënies dhe kontrolli i dijeve (<i>neni 10</i>). Detajimi i metodave të mësimdhënies dhe format e kontrollit të dijeve janë të përcaktuara në programet e lëndëve. <i>Syllabuset e lëndëve janë të miratuara, por jo të publikuara në faqen e TBU dhe të njohura për studentët.</i> <i>Aneksi 5; Aneksi 19</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Stafi akademik në programin e studimit “E Drejtë Biznesi” harton programet e lëndëve përkatëse çdo vit akademik dhe ato miratohen dhe bëhen të njohura për studentët. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin në lidhje me numrin e krediteve, titullarin dhe pedagogët përgjegjës, vitin/semestrin përkatës, temat dhe literaturën respektive, format e kontrollit të dijeve dhe frekuentimin. <i>Aneksi 19</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në nenin 10 të rregullores “Për programet e studimit dhe procesin mësimor”, format e kontrollit të dijeve janë: detyra kursi, provime pjesore, provime përfundimtare, provimet e formimit, projekte kursi dhe temat e diplomave. Në programin e studimit “E Drejtë Biznesi”, titullarët e lëndëve kanë përcaktuar format specifike të aplikuar për çdo modul/lëndë të këtij programi. Përcaktimi i kriterëve dhe peshës së çdo kriteri vlerësimi është i lidhur me natyrën e lëndës p.sh., në disa lëndë aplikohen detyrat e kursit (nga një deri në dy detyra kursi), ndërsa në disa lëndë aplikohen



	testimet, p.sh., në lëndën “E Drejta Civile”, “Procedura Civile”. <i>Aneksi 5; Aneksi 19</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Programi i studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” përmban 21 lëndë, pa përfshirë praktikat profesionale/seminarin special. Në të gjitha lëndët e programit janë të përcaktuara kriteret e vlerësimit përkatës sipas specifikave të tyre. Vlerësimi i studentëve realizohet përgjatë gjithë semestrit që zhvillohet lënda në formën e: pjesëmarrjes aktive në auditor (10%-15%), detyrave të kursit (10%-20%), provimeve apo testeve të pjesëshme (20%-30%) dhe provimit përfundimtar (50%-70%). Çdo lëndë e këtij programi studimi ka të përcaktuar në përqindje peshën e secilit nga komponentët e kontrollit të dijeve. <i>Aneksi 14.1; Aneksi 19</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<i>Institucioni nuk aplikon formën e vlerësimit elektronik.</i> Vlerësimi i studentëve realizohet përmes komisionit të provimit, i cili përbëhet nga së paku dy pedagogë. Titullari i lëndës dhe pedagogët që realizojnë procesin mësimor hartojnë procesverbalin me komponentët e vlerësimit që studenti ka marrë përgjatë gjithë semestrit dhe më pas llogaritet vlerësimi përfundimtar <i>GVJ rekomandon aplikimin e vlerësimit elektronik për të rritur shkallën e transparencës dhe të dhënies së informacionit në kohë reale për studentët.</i> <i>Aneksi 9; Takimi me sekretarinë mësimore</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në bazë të nenit 2 të Rregullores “Për programet e studimit dhe procesin mësimor”, vlerësimi i provimeve realizohet nga pedagogu/pedagogët e lëndës dhe në rastet e lëndëve të zhvilluar vetëm nga një pedagog ose kur të dy pedagogët përgjegjës nuk janë, atëherë përgjegjësi i departamentit ose dekani, përcakton pedagogun që do të jetë pjesë e komisionit. Komisioni i provimeve përbëhet nga së paku dy pedagogë, të cilët kanë zhvilluar procesin mësimor. <i>Aneksi 5; Aneksi 9; Takimi me stafin akademik</i>
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me	Në bazë të nenit 20 të rregullores “Për programet e studimit dhe procesin mësimor”, provimet zhvillohen me shkrim dhe të sekretuar.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafâ», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Zhvillimi i provimeve mbikqyret nga pedagogët e lëndës ose nga personat e caktuar nga drejtuesi i departamentit ose dekani i fakultetit. Sekretaria mësimore, në bazë të nenit 5 të rregullores “Për mbarëvajtjen e procesit mësimor”, është përgjegjëse për realizimin e procesit të sekretimit. <i>Aneksi 5; Aneksi 9; Aneksi shtesë 10</i>								
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Në bazë të rregullores “Për mbarëvajtjen e procesit mësimor”, vlerësimi i studentëve (neni 3) bëhet sipas komponentëve të përcaktuar në programin mësimor të çdo lënde. Pedagogu dorëzon në sekretarinë mësimore, përveç procesverbalit përfundimtar të vlerësimit, edhe tabelën e vlerësimit me komponentët përkatës. <i>Aneksi 9; Aneksi shtesë 10</i>								
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në bazë të rregullores “Për mbarëvajtjen e procesit mësimor”, organizimi i provimit nga ana logjistike realizohet nga sekretaria mësimore (neni 5). Për të shmangur kopjimin, gjatë zhvillimit të provimit, është e ndaluar mbajtja e telefonave apo mjeteve të tjera elektronike. <i>Aneksi 9; Aneksi shtesë 10</i>								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në bazë të nenit 22 të rregullores “Për programet e studimit dhe procesin mësimor”, vlerësimi i provimeve realizohet nga pedagogu/pedagogët e lëndës, brenda afatit kohor të përcaktuar. Studentët kanë të drejtën e reklamimit të vlerësimit brenda një afati tre ditor, pas informimit për rezultatet nga sekretaria mësimore. Rishikimi i rezultatit të provimit bëhet nga komisioni i provimit brenda 7 ditësh nga marrja e njoftimit të reklamimit nga sekretaria mësimore. <i>Aneksi 5; Aneksi 9; Aneksi shtesë 10</i>								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në bazë të nenit 3 të rregullores “Për mbarëvajtjen e procesit mësimor”, vlerësimet mbi çdo komponent të vlerësimit përgjatë semestrit si dhe vlerësimi përfundimtar i bëhet i njohur studentëve përmes sekretarisë mësimore. Puna dhe detyrat e sekretarisë mësimore janë të mirëpërcaktuara në rregulloren “Për sekretarinë mësimore”. <i>Aneksi 9; Aneksi shtesë 10</i>								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në bazë të nenit 3 të rregullores “Për mbarëvajtjen e procesit mësimor”, studentët kanë të drejtën e kontestimit të vlerësimit me anën e një kërkesë pranë sekretarisë mësimore. Nëpërmjet kësaj zyre mundësohet kontakti me pedagogun në lidhje me informacionin shtesë apo sqarimet në lidhje me llogaritjen dhe vlerësimin përfundimtar. Veprimtaria e sekretarisë mësimore është e përcaktuar në rregulloren përktase. Detyrat e sekretarisë janë të lidhura me regjistrimin e studentëve, plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit që lidhet me procesin mësimor, etj. (neni 3 i rregullores përkatëse). Dokumentacioni që lidhet me vlerësimin e provimeve si procesverbali i provimit dhe tabela e vlerësimit të komponentëve sipas programit të lëndës, depozitohen në sekretarinë mësimore. <i>Aneksi 9; Aneksi shtesë 10; Takimi me sekretarinë mësimore</i>								
Shkalla e përmbushjes së	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk</th> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet				
Nuk	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet						

standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bsc. “E Drejtë Biznesi” ofron njohuri bazë në fushën e jurisprudencës përmes lëndëve të karakterit teorik/doktrinal si p.sh., në lëndët: “E Drejtë Publike”, “E Drejtë Romake”, “Filozofia e shtetit dhe së Drejtës” etj. Ky program studimi ofron dhe njohuri specifike në fushën e së drejtës private përmes lëndëve: “E Drejta Private”, “E drejta Civile”, “Procedura Civile”, si dhe njohuri të avancuara në fushë tregtare përmes lëndëve: “E Drejta e Shoqërive Tregtare”, “Gjykimi Administrativ”, “E drejta e Konsumatorit dhe Siguria e Produkteve”, “E Drejta e Konkurrencës dhe Antitrasti”, etj.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Bsc. “E Drejtë Biznesi” ofron njohuri në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit në fushën e biznesit, përmes lëndëve “Komunikimi Profesional dhe Akademik”. Lëndët e këtij programi kanë në përbajtjen e tyre tema që lidhen me aftësimin dhe sigurinë në fushën e biznesit si p.sh. lënda “Sjellja organizative”.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentët, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	Në të gjitha lëndët e këtij programi studimi, janë të përcaktuara rezultatet e pritshme nga procesi i mësimdhënies. Këto aftësi janë të lidhura me objektivat e lëndëve dhe me temat e programit mësimor.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Stafi akademik përcakton në fillim të zhvillimit të çdo lënde qëllimin e saj dhe orienton studentët për mënyrën e përthithjes së informacionit. Metodologjia e çdo lëndë është pjesë e programit mësimor.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik në këtë program studimi organizon seminare të hapura për tematikat dhe zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse (<i>Sipas RVB-së, fq.27 dhe minutave të takimit në institucion me stafin akademik</i>).
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Procesi mësimor realizohet sipas temave të përcaktuara në programin mësimor të çdo lënde, duke mundësuar për studentët aftësimin e kompetencave përkatëse.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Në këtë program studimi nuk ka të parashikuar në planin mësimor orë në laborator, por praktika profesionale për çdo vit akademik.
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Procesi mësimor, në disa prej lëndëve të planit mësimor, realizohet përmes diskutimeve dhe debateve për aktet ligjore të fushës dhe praktikave gjyqësore. Ky lloj procesi realizohet në lëndët: “E drejta civile”, “Procedura civile”, “E drejta penale”, “Procedura penale”, etj.
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e	Stafi akademik e organizon procesin mësimor në auditor në formë interaktive, duke nxitur dhe diskutimet ndërmjet studentëve (<i>nga minutat e takimit në institucion me studentët</i>).
	Institucioni mbështet studentët përmes programeve që mundësojnë materializimin e njohurive të përfutuara në auditor me ato në praktikë.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@ascal.al

shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Përmes krijimit të Inkubatorit të Biznesit (2016-2017), institucioni ka përfshirë një numër studentësh në këtë lloj sipërmarrje.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni inkurajon stafin akademik në përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies, përmes hartimit dhe të udhëzuesve përkatës <i>Aneksi 14.1; Aneksi 19; Aneksi 39</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Në bazë të nenit 27 të rregullores “Për programet e studimit dhe procesin mësimor”, mbrojtja e diplomës bëhet përmes provimit përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës. Përgjegjësi i departamentit në fillim të të semestrit të vitit të tretë akademik/semestri i gjashtë miraton temat e diplomës për çdo student dhe udhëheqësit përkatës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Për mbrojtjen e punimit të diplomës dhe provimit përfundimtar ngrihet komisioni përkatës me miratimin e dekanit. Udhëzuesi “Për përgatitjen e temës së diplomës” është një dokument shumë i mirë orientues për studentët në lidhje me mënyrën e organizimit të temës së diplomës, përdorimit të referencave, etj.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi përfundimtar dhe tema e diplomës (me 6 ECTS), vlerësohet nga komisioni i ngritur për dhënien e provimit përfundimtar, në përbërjen e të cilit janë tre anëtarë të departamentit të lëndëve të përgjithshme. Stafi akademik i programit të studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” mbështet studentët në realizimin e temave të diplomave si dhe në përgatitjen e provimit përfundimtar. Në funksion të realizimit të temës së diplomës është hartuar dhe udhëzuesi përkatës.
Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	Institucioni, përmes udhëzuesve përkatës, orienton studentët për punë kërkimore në fushën përkatëse të studimit.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësi i temës së diplomës miratohet nga drejtuesi i departamentit. Ai ndihmon studentin në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit. Udhëheqësi bën vlerësimin e tij sipas një modeli të miratur në udhëzuesin “Për përgatitjen e temës së diplomës”. Për vlerësimin e temës së diplomës caktohet nga drejtuesi i departamenti dhe recensuesi, i cili e jep mendimin dhe vlerësimin e tij me shkrim sipas formularit që gjendet në udhëzuesin përkatës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për	Studenti vlerësohet nga komisionet përkatëse me vlerësimin me notë si

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

t'u paraqitur para komisionit.	për provimin përfundimtar ashtu dhe për temën e diplomës.			
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në bazë të nenit 30 të rregullores së institucionit studenti pajiset me diplomën përkatëse të shoqëruar me suplementin e diplomës të miratuar nga Ministria përkatëse.			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në rregulloren e institucionit, njësia përkatëse pajis studentët me programet mësimore të të gjitha lëndëve që janë pjesë e planit mësimor përkatës.			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Institucioni ruan dokumentacionin që lidhet me procesin mësimor dhe vlerësimet e studentëve në formën elektronike dhe hard copy. Dokumentacioni ruhet në sekretarinë mësimore, sipas rregullave të përcaktuara në aktet administrative të institucionit.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	<i>Aneksi 5; Aneksi 9; Aneksi shtesë 1; Aneksi shtesë 11; Aneksi shtesë 13; Aneksi shtesë 14; Aneksi 15.1; Aneksi 15.2</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.	Zyra e Financës (e cila mbulon edhe pjesën e burimeve njerëzore) është struktura përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave lidhur me stafin akademik dhe ruajtjen e tyre në dosjet përkatëse. Gjatë vizitës në Institucion u realizua një kontroll i rastësishëm fizik nga GVJ i dy dosjeve të personelit me kohë të plotë dhe dy dosjeve të personelit me kontratë. Dosjet përmbanin dokumentacionin si vijon: CV, kontratë pune, kopje e mjetit të identifikimit, kopje të diplomave, gradave apo titujve akademikë, librezë pune, raport mjeko-ligjor, certifikata pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme, vërtetim pune për personelin me kontratë. Ky dokumentacion përditësohet çdo vit akademik. <i>Gjatë vizitës u konstatua që disa prej kontratave të personelit nuk ishin firmosur ende nga punëmarrësi. IAL deklaroi se kjo nuk ishte realizuar për shkak të</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Staf», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al



	<p><i>situatës pandemike. GVJ sugjeron plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të saktë për personelin akademik.</i></p> <p>Gjithashtu, edhe njësjia bazë mban informacion lidhur me stafin akademik të programit të studimit, lëndët dhe ngarkësën e secilit prej tyre. Për sa i përket personelit ndihmës mësimor, në këtë njësi kryesor nuk ka.</p> <p><i>Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>TBU disponon një “Rregullore për punësimin, largimin dhe vlerësimin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ”, në përputhje me parashikimet e LAL 80/2015 dhe Statutin e Institucionit, ku është e përcaktuar procedura për rekrutimin e personelit akademik. Sipas kësaj Rregulloreje, punonjësit e stafit akademik më kohë të plotë ose të pjesshme, si rregull, pranohen me konkurs. Kriteret specifike të konkurimit propozohen nga departamenti përkatës, miratohen nga Dekani dhe i përcillen Rektorit për miratim. Konkursi shpallet me vendim të Rektorit dhe publikohet në faqen zyrtare të TBU. Shpallja duhet të përmbajë të gjithë informacionin për pozicionin përkatës, duke përfshirë, por pa u kufizuar domosdoshmërisht në detaje, edhe një përcaktim të kriterëve të kualifikimit për pozicionin, si dhe afatin për dorëzimin e kërkesës, e cila regjistrohet pranë sekretarisë mësimore të TBU.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriterëve të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Pas dorëzimit të dokumentacionit, të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret për pozicionin, thërriten për intervistë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriterë të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Për zhvillimin e konkursit, nga ana e Rektorit, ngrihet një komision vlerësimi i përbërë nga përfaqësues të departamentit, fakultetit dhe TBU, i cili harton dhe i paraqet Rektorit për miratim pikët e vlerësimit për çdo kriter të veçantë. Komisioni zbaton kriterë të njëjta në vlerësimin e kandidatëve dhe intervistimi bazohet në materialet që ndodhen në dosjen e kandidatit. Pasi bëhet vlerësimi për secilin kandidat të intervistuar, bëhet renditja e të gjithë kandidatëve sipas rezultatit zyrtar përfundimtar. Vetëm kandidatët, rezultati i të cilëve është “shumë mirë”, rekomandohen për emërim. Raporti i komisionit i përcillet më pas Rektorit të IAL, i cili merr vendimin përfundimtar për punësimin e kandidatit. Nëse Rektori miraton kandidatët e përzgjedhur nga komisioni dhe e dakordëson atë, nënshkruhet kontrata e punës me kandidatin fitues.</p> <p>Në raste të veçanta, kur kandidati është figurë e njohur me ekspertizë shumë të vlefshme për fushën e veçantë për të cilën kërkohet nga TBU, punësimi i tij nuk kalon nëpër procesin e sipërpërmendur, por si rregull janë drejtuesit e njësjive kryesore që i bëjnë propozim Rektorit për punësimin e tij.</p> <p>Pranimi i punonjësve mësimorë të huaj bëhet me propozim të drejtuesve të njësjive kryesore dhe vendim të Rektorit.</p>

	<p>Marrëdhënia e punës rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës. Kontrata individuale e punës specifikon përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e palaëve, ngarkesën mësimore, periudhën e provës, kohëzgjatjen e kontratës, përfundimin e saj, etj.</p> <p><i>Gjithsesi, zbatimi i kësaj procedure nuk rezultoi i konkretizuar. Gjatë vizitës në IAL, u deklarua se, që prej vitit 2014, viti i fundit kur është bërë shpallje publike dhe proces prej të cilit janë punësuar shumë prej pedagogëve që janë aktualisht staf me kohë të plotë në IAL, nuk janë bërë më shpallje publike. Ka shumë kërkesa për punë që vijnë në adresë të IAL, janë bërë shumë intervista dhe kur lind nevoja për lëndë konkrete ose pozicion konkret, shqyrtohen kërkesat që kanë ardhur ose shfrytëzohen njohje personale që mund të ketë stafi aktual i IAL. Për sa më sipër, nuk rezultoi të ketë një zbatim të mirëpërcaktuar të Rregullores së Punësimit, duke mbetur ky proces në vlerësimin diskrecional të brendshëm të strukturave përgjegjëse. GVJ rekomandon një transparencë të plotë në rekrutimin e stafit, si dhe ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të parashikuara nga vetë institucioni për këtë qëllim.</i></p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 11; Vizita në IAL</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	<p>Institucioni garanton kushte të kënaqshme për realizimin e detyrave të stafit akademik në mënyrë të përshtatshme. Nga vizita e realizuar u konstatua se Institucioni disponon zyra të dedikuara për stafin akademik me kohë të plotë si dhe zyrë e tavolina pune edhe për stafin akademik me kontratë. Gjithashtu, Institucioni disponon edhe një sallë mbledhjesh, e cila përdoret në rastet e mbledhjeve të njëjësive bazë, kryesore, senatit, etj. Gjithashtu, gjatë vizitës u konstatua se ekziston një frymë mbështetjeje dhe nxitjeje për stafin akademik nga ana e drejtuesve të Institucionit si dhe një frymë bashkëpunimi mes vetë stafit akademik.</p> <p><i>Vizita në IAL, vëzhgimi i ambjentëve</i></p>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	<p>Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit akademik të programit të studimit, organizimin e konferencave shkencore kombëtare, seminareve, debateve shkencore të fushës së jurisprudencës, ku janë ftuar edhe personalitete të njohura akademike. Institucioni ka një Strategji të Kërkimit Shkencor si dhe një Qendër për kërkimin shkencor, e cila përpilon edhe Raport vjetor për veprimtarinë e</p>



	<p>saj. Gjatë vizitës në institucion, në takimin me Zyrën e Financës dhe Administratorin e TBU, u sqarua se në Planin Buxhetor Afatmesëm parashikohet që 20 % e buxhetit dedikohet për kërkimin shkencor, dhe më së shumti kjo shifër reflektohet në pagat mujore të stafit.</p> <p><i>Megjithatë, rezulton se formimi shkencor dhe rritja e mëtejshme e stafit akademik mbeten kryesisht iniciativë individuale.</i> Për këtë program studimi, që prej vitit 2016, evidentohen tre raste të mbështetjes nga Institucioni me suport financiar për botim, ku një është pedagog me kohë të plotë në këtë program, një nuk është personel akademik i këtij programi/departamenti (bazuar në tabelat e përcjella nga TBU) dhe autori tjetër është pjesë e listës së personelit akademik të këtij programi në vitin akademik 18-19. <i>Gjithsesi kjo mbështetje mbetet sporadike dhe jo e strukturuar në vazhdimësi dhe në bazë kriteresh të mirëpërcaktuara.</i> <i>GVJ rekomandon që të këtë një mbështetje të strukturuar dhe të mirëpërcaktuar nga IAL për kërkimin shkencor të stafit akademik.</i></p> <p>Gjithashtu, TBU bashkëpunon me “International Institute for Private, Commercial and Competition Law” (ku Dekani i Fakultetit që ofron këtë program studimi është anëtar i Bordit Shkencor Ndërkombëtar), për botimin e revistës “Balkan Journal of Interdisciplinary Research” (ku Dekani i Fakultetit është Kryeredaktor).</p> <p><i>Aneksi 3.2; Aneksi S.4.1; Aneksi S.4.2; Aneksi S.8</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një Udhëzues për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, e cila i shërben kualifikimit të mëtejshëm profesional të stafit akademik, si dhe një Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Nga takimi në institucion u evidentua që infrastruktura teknologjike lejon zhvillimin e mësimdhënies me mjete informatike dhe gjithashtu edhe nga takimi me studentët u evidentua fakti i përdorimit me sukses i teknologjisë së informacionit për zhvillimin e leksioneve në kohën e pandemisë.</p> <p><i>Nga dokumentacioni i përcjellë nga IAL dhe vizita e realizuar, nuk u evidentua realizimi nga ana e IAL i ndonjë trajnimi për metodat inovative të mësimdhënies apo përdorimin e teknologjive të reja.</i> <i>GVJ rekomandon marrjen e masave për realizimin e trajnimeve të stafit akademik mbi metodat inovative dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.</i></p> <p><i>Aneksi 32; Aneksi 34; Aneksi 39; Aneksi 43; Aneksi 46</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni dëshmon një angazhim të mirë të burimeve njerëzore të tij për përmbushjen e objektivave të programit të studimit, përmes angazhimit në të stafit akademik me kualifikimin akademik dhe shkencor në përshtatje me lëndët e planit mësimor, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera kryesore të Institucionit.</p> <p><i>Aneksi 20; Aneksi 24</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p style="margin: 0;">X</p>				

Standardi IV.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies, e evidentuar edhe nga vizita në ambjentet e institucionit. Vlen për tu përmendur që Institucioni garanton në mënyrë efektive edhe aksesin për personat me aftësi të kufizuara, duke qenë se është i pajisur me rampë hyrëse dhe ashensorë.</p>			
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sallat dhe klasat e Institucionit janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit mjaftueshëm për të garantuar mësimdhënie përmes këtyre teknologjive. Institucioni garanton akses në mënyrë të vazhdueshme në internet përmes ëifi. Edhe gjatë vizitës në Institucion, u mundësia realizimi i një prej takimeve të agjendës me stafin përgjegjës online, pa probleme teknike.</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Duke pasur parasysh që vetë programi i studimit nuk kërkon një teknologji të avancuar për zhvillimin e tij, nevojat laboratorike dhe të sallës së internetit Institucioni i plotëson në sallën e bibliotekës, e cila është e pajisur gjerësisht me mjetet e nevojshme të teknologjisë së informacionit.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni ka një përqëndrim specifik dhe interes të shtuar për praktikën dhe ndërthurjen e saj me teorinë, gjë e cila rezulton edhe nga mënyra e konceptimit të programit mësimor. Për këtë, Institucioni disponon edhe një Rregullore për praktikën mësimore. Realizimi i praktikës profesionale bëhet i mundur falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që Institucioni ka me Institucionet bashkëpunuese, si dhe ndihmohet nga fakti që një pjesë e stafit akademik janë praktikantë të së drejtës nëpërmjet zyrave të avokatisë apo si magjistratë, si dhe nga numri i vogël i studentëve në këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p><i>Aneksi 42; Aneksi shtesë 8; Aneksi shtesë 18; Aneksi 32; Aneksi 47; Aneksi 14.1</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën mësimore, e cila ka ambiente të përshtatshme, madhësi salle, kompjutera, dritë natyrore, mjete ngrohje-ftohje si dhe një person të dedikuar për mbarëvajtjen e punës në të. Aksesit në bibliotekë është i garantuar në mënyrë të barabartë si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.</p>			
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur fizikisht me literaturë në gjuhën shqipe dhe të huaj si edhe me revista shkencore. Ajo mbulon një pjesë të madhe të literaturës së kërkuar për mbulimin e moduleve të veprimtarisë mësimore. <i>Gjithsesi, evidentohet mungesa e disa teksteve të nevojshme për programin e studimit dhe një numër i vogël i kopjeve të teksteve të disponueshme. GVJ rekomandon përfshirjen në bibliotekë të të gjitha teksteve të parashikuara në programin e studimit dhe shtimin e numrit të kopjeve për tekst.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton akses pa pagesë në bibliotekën online EBSCO, në të cilën ofrohen mbi 40.000 tituj (Business Source Complete Database). Gjatë vizitës në institucion u bënë disa prova nga GVJ për aksesin në bibliotekën on line për tekste të huaja në gjuhën italiane dhe angleze dhe rezultoi që biblioteka ishte funksionale dhe ofronte gamë të gjerë tekstesh të ndryshme juridike në gjuhë të huaj.</p>			
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me kompjutera në sasi të konsiderueshme dhe me akses në internet, duke krijuar mundësinë e shfrytëzimit pa kufizime nga ana e studentëve.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p><i>Ndryshe nga sa referohet në RVB (fq. 33) nuk rezulton që të ketë një plan të detajuar për Bibliotekën e Institucionit për shtimin e zërave të bibliotekës apo përditësimin e fondit ekzistues. Paçka se kjo parashikohet në planin për Bibliotekën, nuk u vu në dispozicion një procedurë e detajuar në lidhje me pikën 1 të Urdhërit të Rektorit Nr. 15, datë 18/10/2019.</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e Institucionit mund të aksesohet në orarin 09:00-21:00, orar ky i përshtatshëm për shfrytëzimin e saj në mënyrë të barabartë dhe pa kufizim nga të gjithë studentët dhe stafi akademik.</p> <p><i>Aneksi 46; Aneksi shtesë 16</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

standardit			X	
------------	--	--	---	--

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	TBU ka implementuar një sistem online interaktiv (<i>Sistemi i Menaxhimit të Studentëve</i>) që mundëson lehtësimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit. Ky sistem i shërben studentëve të aksesojnë notat, të komunikojnë me stafin, të lexojnë materiale mësimore, të informohen për ecurinë e pagesave, të marrin informacion lidhur me eventet e TBU apo njoftime të ndryshme, etj. Sistemi gjithashtu i shërben stafit akademik për të depozituar materiale ndihmëse e për të komunikuar me studentët dhe strukturat e tjera të TBU. Stafi drejtues i TBU dhe zyrat e tjera ndihmëse (sekretari, marketing, financë) mund të monitorojnë aspekte të caktuara të lidhura me veprimtaritë respektive. Gjithashtu, Institucioni shfrytëzon edhe aplikacione si Google Drive, Dropbox apo Google Classroom, ku pedagogë të caktuar ngarkojnë materialet e tyre lëndore dhe komunikojnë në mënyrë interaktive me studentët. Stafi akademik, administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë email, të identifikuar nga TBU (emër.mbiemër@tbu.edu.al).			
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Krahas sistemit “intranet” dhe “website”, Sekretaria Mësimore njofton rregullisht studentët dhe pedagogët mbi procesin mësimor, shpërndarjen e materialeve didaktike, aktivitetet e ndryshme që zhvillohen e deri tek informacione të personalizuara.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	TBU publikon në faqen e tij zyrtare të internetit të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, njoftimet, bazën ligjore, kurrikulat dhe planet mësimore, si dhe informacione të tjera që lidhet me veprimtarinë akademike të Institucionit, në gjuhën shqipe dhe angleze. <i>Megjithatë, në faqen e internetit, nuk gjenden të publikuara syllabuset e programit, si dhe gjithashtu, informacioni që paraqitet në gjuhën angleze nuk është i plotë (https://tbu.edu.al/en/programet). Informacioni i paraqitur në web në gjuhën angleze të orienton tek broshura e studentit, e cila është në gjuhën shqipe. Institucioni, duhet të plotësojë e përditësojë informacionin e paraqitur në faqen e tij zyrtare, për këtë program studimi, në mënyrë që ai të mund të jetë i plotë dhe i aksesueshëm nga kushdo.</i>			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Aneksi 46; Aneksi 48; www.tbu.edu.al			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.				
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë rezulton se institucioni harton një Raport financiar për programin e studimit Bachelor në “E drejtë biznesi”. Të dhënat mbi të ardhurat dhe financimet për këtë program studimi janë paraqitur nga viti akademik 2016-2017 dhe deri tek parashikimet për vitin akademik 2023-2024. Kryesisht ky Raport financiar bëhet i mbështetur mbi Planin strategjik të zhvillimit të programit të studimit Bachelor në “E drejtë biznesi” 2018-2024, ku parashikohen arritjet dhe objektivat për vitet në vazhdim. Nga të dhënat e paraqitura për këtë program, të ardhurat e vetme të institucionit janë nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, ndërkohë që shpenzimet shkojnë kryesisht për: personel akademik dhe joakademik, qera dhe shpenzime dhe amortizim.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Sipas të dhënave të paraqitura, rezulton se institucioni harton dhe bën publik, për çdo vit akademik, një raport vjetor, ku reflektohen ndër të tjera edhe aspekte financiare të institucionit dhe përdorimit të fondeve për vitin pasardhës.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Plani strategjik i zhvillimit të programit të studimit parashikon mënyrën e financimit me shifra dhe % për garantimin e realizimit të programit për shpenzimet operative, investimet dhe teknologjinë. Gjithashtu, i dedikon një vëmendje të veçantë kërkimit shkencor dhe gjithë infrastrukturës në mbështetje të tij.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Sipas Statutit të TBU (neni 54), kontrolli dhe auditimi i brendshëm realizohet nga njësia e auditimit të brendshëm të institucionit, që ngrihet dhe funksionon me vendim të Bordit të Administrimit, ndërsa auditimi i jashtëm, realizohet konform neni 116, pika 2 e LAL, nga një auditues i jashtëm i përzgjedhur nga Bordi i Administrimit. <i>Institucioni ka vënë në dispozicion një raport auditimi të pavarur për vitin 2018.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në të dhënat financiare të paraqitura, mund të thuhet se Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit. <i>Aneksi 2; Aneksi 4; Aneksi 47; Aneksi 49; Aneksi shtesë 17</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura për mbulimin e ciklit të plotë akademik të studentëve që nga hyrja e tyre deri në dalje, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe aktet e tij të brendshme rregullatore si: Statut, Rregullore për programet e studimit dhe procesin mësimor, Rregullore për programin e studimit, Rregullore për sekretarinë mësimore, Rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor, Rregullore për praktikës mësimore, Udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës, etj. Në këto akte të brendshme rregullatore nuk rezulton të çenohet parimi i barazisë për kandidatët për studentë dhe studentët e programit.</p> <p>Institucioni ndjek një politikë të mirëpërcaktuar në pranimin e studentëve, të bazuar në kriteret të përgjithshme dhe të posaçme. Kriteret e përgjithshme të pranimit të një kandidati janë ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ndërsa kriteret e posaçme përcaktohen në rregulloren e programit të studimit ose me vendim të Senatit Akademik. Në programin e studimit Bsc. E drejtë biznesi, mund të regjistrohen të gjithë ata studentë që zotërojnë të paktën një diplomë të shkollës së mesme, shqiptarë ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga ministria përgjegjëse për arsimin, si dhe studentët me transferim.</p> <p>Kriteret e pranimit për këtë program janë:</p> <p>1. Sipas VKM-së përkatëse, TBU parashikon që nota mesatare e ciklit të</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	
Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.

Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.

arsimit të mesëm për kandidatët që do të pranohen në këtë program do të jetë 6. Për renditjen përfundimtare të studentëve që do të pranohen, mesatarja do të përbëjë 60 % të vlerësimit përfundimtar për çdo aplikant, ku kandidati me mesataren më të lartë do të marrë 60 pikë, ndërsa ai me mesataren minimale sipas VKM-së do të marrë 1 pikë;

2. Konkurim përmes intervistave për shkallën e motivimit dhe angazhimit të aplikantit për të studiuar dhe për t'u aftësuar profesionalisht në programin përkatës si dhe e pranueshmërisë prej tij të metodologjisë formuese dhe rregullave të përcaktuara nga TBU. Ky kriter përbën 40 % të vlerësimit përfundimtar për çdo aplikant. Aplikanti me shkallën më të lartë të motivimit dhe angazhimit do të marrë 40 pikë, ndërsa ai me shkallën më të ulët do të marrë 1 pikë.

Lidhur me kuotat e pranimit ato janë të kufizuara, pasi sipas IAL, vihet theksi tek cilësia e studentëve. Në vitin akademik 19-20 janë parashikuar 30 studentë, si dhe 5 me transferim. *Në vitet e fundit akademike, vihet re se nuk ka patur kuota të përcaktuara për kandidatë nga trojet, shtetas të huaj, persona me aftësi të kufizuara, me statusin jetim, apo për kandidatë nga komuniteti romë dhe ballkano-egjiptian.*

TBU ofron mundësi për transferimin e studimeve në përputhje me LAL. Në vlerësimin e krediteve të transferueshme merret parasysh çdo dije dhe shprehje e fituar nga studenti në programet e mëparshme e që janë të krahasueshme me programin në të cilin kërkohet transferimi. Vendimi për njohjen e krediteve dhe programit që duhet të ndjekë studenti, në përputhje me LAL, merret nga komisioni përkatës i ngritur nga njësia bazë përkatëse. Nëse një student, pas përfundimit të një programi studimi, kërkon të regjistrohet në një program tjetër studimi të të njëjtit cikël, kreditet e fituara në programin e parë për lëndë të njëjta ose të ngjashme ndërmjet këtyre programeve, transferohen në programin tjetër. Pas plotësimit të të gjitha detyrimeve të tjera që rrjedhin nga programi i dytë, studenti mund të diplomohet edhe në programin e dytë.

Informacioni lidhur me procedurat dhe kriteret e sipërpërmendura është publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë në faqen zyrtare të internetit të TBU.

IAL, përmes bashkëpunimit të të gjitha strukturave të tij, ndjek disa politika marketingu, si vijon:

- Konkursi kombëtar "Juristët e në nesërme": organizohet çdo vit, që prej vitit 2014, në formën e një "gjqyqi imitues", ku ftohen të marrin pjesë gjimnazistë (kryesisht maturantë) nga i gjithë vendi, me prirje dhe pasion drejtësinë. Ky konkurs shërben për të identifikuar e mbështetur me bursa të rinj me iniciativë dhe potencial për tu zhvilluar në fushën

	<p>juridike;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në aktivitete të këshillimit të karrierës: TBU angazhohet të marrë pjesë në çdo aktivitet që lidhet me orientimin dhe këshillimin për maturantë dhe të rinj, si panaire, ditë informimi, etj. Në këto aktivitete, përfaqësuesit e TBU (midis të cilëve edhe studentë), informojnë mbi programet e studimit, rezultatet në karrierë të studentëve alumni, kriteret dhe kuotat e pranimit, mundësitë për zbritje në tarifë/bursë studimi, evente të planifikuara, etj; - Organizimi i aktiviteteve formuese në/nga TBU: në mjediset e Institucionit organizohen aktivitete të ndryshme formuese që lidhen me programin e studimit dhe/ose i shërbejnë rritjes personale dhe profesionale të studentëve, dhe inkurajon pjesëmarrjen e komunitetit (gjimnazistë, pedagogë, stafe të kompanive partnere, etj); - Takime në TBU: institucioni mirëpret çdo ditë kandidatë të interesuar për vijim e studimeve. Në këto takime njihen me frymën dhe modelin e TBU, mjediset e IAL, si dhe zhvillojnë bashkëbisedime me përfaqësues të stafit drejtues dhe administrativ; - Marketingu digjital: promovimi i njoftimeve dhe aktiviteteve në faqen e internetit dhe rrjetet sociale; - Partneriteti me kompanitë: për të vlerësuar bashkëpunimin me subjekte partnere, institucioni kujdeset të ofrojë reduktim të tarifës/bursës për stafet e tyre që dëshirojnë të ndjekin studimet. Kompanitë partnere informohen me email, si rregull, në periudhën korrik-shtator të çdo viti akademik. <p><i>Aneksi 2; Aneksi 5; Aneksi 7; Aneksi 9; Aneksi 47; Aneksi 51; Aneksi shtesë 1; Aneksi</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe përparimit akademik të studentëve, si dhe dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të parashikuara në Rregulloren për programet e studimit dhe procesit mësimor, Rregulloren për mbarëvajtjen e procesit mësimor, si dhe më specifikisht zërthehen dhe konkretizohen në syllabuset e çdo lënde.
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në fillim të çdo viti akademik, stafi akademik dhe ai administrativ i TBU organizon sesione informuese për studentët, përfshirë edhe për
Kriteri 3. Institucioni informon	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafë», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	këto rregulla e kriteret. Gjithashtu, mënyra e vlerësimit i bëhet me dije studentëve që në orën e parë të prezantimit të lëndës nga pedagogët, së bashku me elementët e tjerë të zhvillimit të lëndës, si dhe i dërgohet studentëve me email në javën e parë të fillimit të lëndës.			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	TBU, sikurse përmendur edhe më sipër në standardin V.1, ofron mundësi për transferimin e studimeve në përputhje me LAL. Vendimi për njohjen e krediteve dhe programit që duhet të ndjekë studenti merret nga komisioni përkatës i ngritur nga njësia bazë përkatëse. Ky informacion është i parashikuar në disa prej akteve të brendshme rregullatore të Institucionit (si psh. Statut, Rregullore për programet e studimit dhe procesin mësimor, etj.) dhe i vihet në dispozicion studentëve përmes faqes së tij zyrtare të internetit dhe informimit që realizohet nga struktura të ndryshme të tij.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Procedura dhe kriteret për diplomimin e studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren për programet e studimit dhe procesin mësimor, si dhe gjithashtu Institucioni ka të miratuar një Udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës, për ata studentë të cilët zgjedhin të diplomohen me temë diplome. Nga takimi në Institucionit me studentët e këtij programi, u evidentua se pjesa më e madhe e tyre kishin zgjedhur të diplomoheshin me provim formimi dhe jo me temë diplome.			
	Sikurse përmendur edhe në standardin e mësipërm, TBU ndjek disa politika marketingu, përmes së cilave informon kandidatët për studentë dhe personat e interesuar për programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Sikurse përmendur edhe më lart, në fillim të çdo viti akademik, stafi akademik dhe ai administrativ i TBU organizon sesione informuese për studentët, për ti njohur ata me strukturën e programit të studimit, organizimin, përmbajtjen, kohëzgjatjen e tij, stafin akademik, organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën, shërbimet, etj.
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Një prezantim i tillë më specifik, së bashku dhe me elementë të tjerë të zhvillimit të lëndës, realizohet edhe nga pedagogët e secilës lëndë në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>orën e parë të prezantimit, si dhe i dërgohet studentëve me email në javën e parë të fillimit të lëndës.</p> <p>Informacioni mbi programin e studimit është gjithashtu i aksesueshëm përmes Sistemit të Menaxhimit të Informacionit dhe është i publikuar në faqen zyrtare të internetit, në gjuhë shqipe. <i>Sikurse përmendur edhe më sipër, Institucioni duhet të plotësojë e përditësojë informacionin e paraqitur në faqen e tij zyrtare, për këtë program studimi.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>TBU, përmes Zyrës së Karrierës dhe Punësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - informon studentët në mënyrë të vazhdueshme lidhur me mundësi për realizimin e praktikës profesionale/internship, punësim, aktivitete formuese, bursa studimi, konkurse, panaire, konferenca, etj. - organizon senaca trajtimi në grup dhe këshillim individual për procese të lidhura me orientimin dhe zhvillimin në karrierë (përgatitja për intervistë pune, hartimi i CV-së dhe letrës së motivimit, ndërtimit të një profile profesional në LinkedIn, etj.); - koncepton, planifikon dhe organizon aktivitete formuese (leksione, seminare, trajnime, etj.) për tema që lidhen me përmirësimin e aftësive ndërpersonale, teknike, etj.; - ndërmjetëson dhe koordinon me pedagogë e staf drejtues për pajisjen e studentëve të interesuar me referenca për punësim apo studime. 			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Nga të dhënat e paraqitura në studimin e tregut të punës të realizuar nga Institucioni, pas diplomimit të studentëve në vitin akademik 18-19, rezulton se nga 24 studentë të diplomuar në këtë program studimi, 23 prej tyre (rreth 96 %) janë të punësuar, prej të cilëve 16 (rreth 70 %) në përputhje me fushën e studimit dhe 7 (rreth 30 %) jo në përputhje me fushën e studimit. Ndërkohë që në vitet e mëparshme akademike, përqindja e numrit total të të punësuarve ka qenë 85.71 % në vitin akademik 17-18 dhe 41.6 % në vitin akademik 16-17.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në Institucion, u evidentua që disa prej studentëve të diplomuar në TBU, janë të punësuar pranë këtij Institucioni.</p> <p>Angazhimi i Institucionit në informimin e studentëve mbi mundësitë e punësimit dhe në orientimin drejt tregut të punës u evidentua edhe nga studentët e këtij programi, në takimin që u realizua me ta.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik

të brendshëm				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.		Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. GVJ, gjatë vizitës në Institucion, verifikoi regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave të studentëve dhe konstatoi korrektesë në mbajtjen dhe regjistrimin e këtyre të dhënave. <i>Megjithatë, duhet përmendur se në regjistrin themeltar, nuk ishin pasyqyruar ende të dhënat për vitin akademik 18-19.</i>		
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.		Nga shqyrtimi i të dhënave të paraqitura dhe regjistrave përkatës, rezultojnë se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, numrin e studentëve të tërhequr nga programi apo largimet para përfundimit të programit. Institucioni disponon të dhëna të detajuara për ecurinë e studentëve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto u konstatuan nga verifikimi i regjistrave dhe dosjeve personale të studentëve në sekretarinë mesimore. Dokumentacioni ruhet në formë të shkruar dhe në formë elektronike.		
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.		Institucioni harton e publikon çdo vit raportin vjetor, pjesë përbërëse e të cilit është edhe analiza e cilësisë në hyrje dhe në dalje të studentit që frekuenton programin e studimit, si dhe punësimi i studentëve, brenda e jashtë profilit. Gjithashtu, këto të dhëna janë pjesë e analizës së departamentit mbi arritjen e objektivave të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Në muajin Janar 2020, Institucioni ka realizuar edhe një studim të tregut të punës, pas diplomimit të studentëve të vitit akademik 18-19.		
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.		Institucioni disponon gjithashtu edhe një databazë me studentët alumni, me të cilët mban kontakte të herëpashershme për përditësimin e saj, si dhe mban të dhëna për institucionet ku janë të punësuar studentët. <i>Aneksi 27; Aneksi 38; Aneksi 47; Aneksi 29; Aneksi S.3 (gjatë vizitës)</i>		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e	Institucioni, përmes akteve të tij të brendshme rregullatore (Statut,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al


<p>studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Rregullore e NJSBC-së) parashikon përfshirjen e studentëve në disa prej organeve vendimmarrëse. Sipas Statutit:</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>- dy prej anëtarëve të Senatit Akademik janë studentë, një për secilin fakultet, të cilët zgjidhen nga studentët e fakultetit përkatës mes studentëve me rezultatet më të larta, të vetëkandiduar;</p> <p>- dy prej pesë anëtarëve të Komisionit të Cilësisë janë studentë (në nivel institucioni dhe fakulteti);</p> <p>- dy prej pesë anëtarëve të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët janë studentë (në nivel institucioni dhe fakulteti).</p> <p>Gjithashtu, sipas Rregullores së Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, njësia përbëhet nga tre anëtarë, ku një prej tyre është nga Qeveria Studentore.</p> <p>Gjithashtu, studentët përfshihen edhe në kuadër të proceseve të akreditimit të Institucionit/programeve të studimit, si pjesë e Grupeve të Vetëvlerësimit, sikurse edhe në rastin e programit të studimit që po vlerësohet.</p> <p>Gjithashtu, TBU, krijon hapësirat e duhura për funksionimin e Këshillit Studentor (KS) si një organizim i pavarur i studentëve.</p> <p>Informacioni i mësipërm u konfirmua edhe në takimin e realizuar me studentët e këtij programi, ku një prej studentëve të pranishëm në takim ishte përfaqësues në Këshillin Studentor dhe Senatit Akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Aneksi 2: Aneksi 8 Programi Bachelor në “E drejtë biznesi” është hartuar në mënyrë të tillë që merr parasysh ngarkesat javore dhe vjetore të studentëve në program, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, pra jo më shumë se 25 orë në javë, të paktën 60 kredite në vit. Numri minimal i orëve mësimore që zhvillohen në auditor në një ditë është 3 orë dhe ai maksimal 5 orë, ndërsa numri i orëve mësimore në javë varion 18-25 orë mësimore.</p> <p>Orari mësimor ndërtohet mbi kriteret pedagogjike duke kombinuar format e mësimdhënies dhe siguruar një shpërndarje sa më harmonike të ngarkesës së studentit gjatë orëve të një dite dhe përgjatë ditëve kur zhvillohet mësimi.</p> <p>Ky orar përgatitet nga Dekanët dhe shpallet nga Rektori, në përputhje me strukturën akademike të vitit akademik të miratuar nga Senati. Ndryshimet bëhen me kërkesë të pedagogut dhe/ose studentëve e të dakordësuar mes tyre, pas njoftimit të dekanit dhe dakordësisë së tij. Ndryshimet e përhershme apo afatgjata në orarin mësimor, pasi ka filluar viti akademik, bëhen nga Dekani dhe shpallen nga Rektori.</p> <p><i>Aneksi 5</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit</p>	<p>Studentët, në përfundim të çdo semestri/viti akademik, ftohen të plotësojnë pyetësorët, ku mund të shprehin në mënyrë anonime</p>

<p>të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>mendimin e tyre në lidhje me lëndën, ngarkesën, organizimin e orës së mësimin nga ana e pedagogut, metodologjinë dhe teknikat e përdorura, kontrollin e dijeve të studentëve, materialin e përfshirë në leksione, etj. Kjo është një mënyrë indirekte e përfshirjes së opinionit të studentëve për përmirësimin e programit mësimor.</p> <p>Gjatë vizitës në IAL, në takimin me stafin akademik dhe studentët e programit, u shpreh se, biseda të tilla, zhvillohen përgjatë të gjithë vitit, edhe në mënyrë informale e takime që zhvillojnë me njëri-tjetrin.</p> <p>Gjithashtu, edhe në Statutin e TBU, parashikohet që Këshillat Studentorë janë të mirëpritur dhe garantohet dhënia e mendimit nga ana e tyre për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm që lidhen me veprimtarinë mësimore kërkimore si: planet dhe programet e studimit, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, etj.</p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 40; Takimi me stafin akademik dhe studentët</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Aktet e brendshme rregullatore (si psh. Rregullorja për programet e studimit dhe procesin mësimor; Rregullore për mbarëvajtjen e procesit mësimor) garantojnë se studentët kanë mundësinë e informimit dhe ankimimit mbi ndershmërinë e vlerësimit të kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e rishikimit nga ana e pedagogut.</p> <p>Gjatë takimit me studentët e programit, u përmend prej tyre një rast kur mendimi i tyre ishte marrë në konsideratë, dhe propozimi ishte paraqitur zyrtarisht në Dekanat nga Përgjegjësi i Departamentit. Në këtë propozim thuhej që, si rezultat i konsultimeve të zhvilluara në ambjentet e Institucionit, me studentët e vitit të dytë, në një nga lëndët e zhvilluara në atë vit, rezultati i provimit nuk ishte në nivelin e dijeve të paraqitura nga ana e tyre, dhe kërkohej mundësia e realizimit të disa seancave shtesë dhe ripërsëritjes së provimit, si një mundësi për të prezantuar edhe një herë nivelin e dijeve të tyre. Pas marrjes në shqyrtim të këtij propozimi nga ana e Dekanit, u vendos që të zhvilloheshin konsultime për lëndën dhe riprovimi i lëndës, në përfundim të orëve të konsultimit. Sipas studentëve, këto orë konsultimi u zhvilluan nga një tjetër pedagog dhe në mënyrë më interaktive.</p> <p><i>Aneksi 5; Aneksi 9; Aneks shtesë 10; Aneks S.10</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi V.6

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------



<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>TBU ka procedura e struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore, si: Sekretaria mësimore, Zyra e Çështjeve Studentore (ku përfshihet dhe Zyra e Karrierës dhe Punësimit), Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Koordinatori i Programit të Studimit (në këtë rast Përgjegjësi i Departamentit). Këto struktura, në funksion të realizimit të informimit, këshillimit, ndjekjes e përparimit të studentëve, janë gjithmonë në bashkëpunim me njësinë bazë përgjegjëse për këtë program studimi si dhe stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu, në nivel institucioni dhe fakulteti, sipas statutit të IAL, është ngritur dhe Komisioni i Marrëdhënieve me Studentët, i cili ka për detyrë monitorimin dhe sigurimin e marrëdhënieve të përshtatshme të studentëve dhe alumni me TBU. Ky komision përbëhet secili nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 personel akademik dhe 2 studentë dhe funksionon sipas një rregulloreje që miratohet nga Senati Akademik. <i>Megjithatë, Institucioni ka një rregullore për funksionimin e organeve kolegjiale të TBU, ndërmjet të cilave edhe ky komision, ku parashikohet në vija të përgjithshme përbërja, organizimi dhe funksionimi i tij si organ kolegjial (mënyra e realizimit të mbledhjeve, kuorumi, marrja e vendimeve, procesverbali i mbledhjes, efektet juridike të vendimeve), por nuk ka një rregullore specifike ku të dalin në pah në mënyrë të qartë e të detajuar roli i tij, funksionet dhe veprimtaria që realizon, në përputhje me Statutin e IAL. Roli i këtij komisioni nuk doli në pah as gjatë vizitës në Institucion. GVJ rekomandon miratimin e një Rregulloreje ku të detajohen të gjitha aspektet e detajuar më lart.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Numri i vogël i studentëve në këtë program dhe në tërësi në Institucion, si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit, ndihmojnë e lehtësojnë realizimin dhe ofrimin e këtij shërbimi.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>TBU, përmes Zyrës së Karrierës dhe Punësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - informon studentët në mënyrë të vazhdueshme lidhur me mundësi për realizimin e praktikës profesionale/internship, punësim, aktivitete formuese, bursa studimi, konkurse, panairë, konferenca, etj. - organizon senaca trajtimi në grup dhe këshillim individual për procese të lidhura me orientimin dhe zhvillimin në karrierë (përgatitja për intervistë pune, hartimi i CV-së dhe letrës së motivimit, ndërtimit të një profile profesional në LinkedIn, etj.); - koncepton, planifikon dhe organizon aktivitete formuese (leksione, seminare, trajnime, etj.) për tema që lidhen me përmirësimin e aftësive ndërpersonale, teknike, etj.; - ndërmjetëson dhe koordinon me pedagogë e staf drejtues për pajisjen e studentëve të interesuar me referenca për punësim apo studime.



	<p>Në përgjegjësitë e kësaj zyre janë:-</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi, vlerësimi, dokumentimi dhe raportimi sistematik tek strukturat drejtuese të TBU i ecurisë së aftësisë praktik, punësimit e avancimit në karrierë të studentëve/alumni; - Koordinimi me strukturat e tjera për rritjen e efektivitetit të shërbimeve të zyrës; - Ruajtja dhe forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me subjektet partnere; - Organizimimi i takimeve mes studentëve të diplomuar dhe studentëve aktual me qëllim njohjen mes tyre, shkëmbimin e përvojave personale dhe nxitjen e bashkëpunimit; - Nxitja e përfshirjes së studentëve me rol organizativ në aktivitete e projekte të TBU; - Ruajtja e të dhënave të punësimit të studentëve dhe përditësimi i tyre për qëllime analize; - Promovimi i veprimtarisë së zyrës në faqen zyrtare ëeb të TBU dhe mediat sociale. <p><i>Aneksi 2; Aneksi 12</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR


Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në Statutin e Institucionit përcaktohet se sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili një organ i pavarur që krijohet në rang institucioni me vendim të Senatit Akademik. Kjo njësi menaxhon dhe siguron cilësinë në të gjitha njësitë e Institucionit, si dhe raporton drejtpërdrejtë tek Rektori dhe Senati Akademik. Njësia përbëhet nga tre anëtarë që emërohen drejtpërdrejt nga Senati, ku njëri prej anëtarëve është nga Qeveria Studentore. Në punën e saj, NJSBC, bazohet në parimet ligjore, Kodin e Cilësisë dhe parimet e Standardeve dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al

jashtëm.	Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Gjithashtu, në nivel institucioni dhe nivel fakulteti, është ngritur Komisioni i Cilësisë, një komision i përhershëm, i cili ka për detyrë garantimin e standardeve të cilësisë së Institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 personel akademik dhe 2 studentë, dhe funksionon sipas një rregulloreje që miratohet nga Senati Akademik.</p> <p><i>Sikurse përmendur edhe më sipër, Institucioni ka një rregullore për funksionimin e organeve kolegjiale të TBU, ndërmjet të cilave edhe ky komision, ku parashikohet në vija të përgjithshme përbërja, organizimi dhe funksionimi i tij si organ kolegjial (mënyra e realizimit të mbledhjeve, kuorumi, marrja e vendimeve, procesverbali i mbledhjes, efektet juridike të vendimeve), por nuk ka një rregullore specifike ku të dalin në pah në mënyrë të qartë e të detajuar roli i tij, funksionet dhe veprimtaria që realizon, në përputhje me Statutin e IAL. Roli i qartë i këtij komisioni nuk doli në pah as gjatë vizitës në Institucion.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjsteve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p><i>Sipas Statutit të TBU, në përbërjen e njësisë nuk parashikohet si anëtar një ekspert apo bashkëpunëtor i jashtëm, megjithatë, gjatë veprimtarisë së tij, TBU ka përfshirë në njëfarë mënyrë ekspertizën e tyre.</i></p> <p>Konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - pranë TBU, që prej fillimit të veprimtarisë së tij, është ngritur dhe funksionon Bordi Ndërkombëtar Këshillimor, i cili ka ndihmuar në zhvillimin e strategjisë dhe ka kontribuar në disa aktivitete të tij; - në nëntor të vitit 2016 është realizuar një vlerësim nga një ekspert hollandez lidhur me performancën institucionale, ofertën akademike, impaktin e të nxëniet praktik të studentëve, shkallën e tërheqjes së studentëve në tregun e punës, si dhe për lehtësimin e vendosjes së kontakteve dhe bashkëpunimit me shkolla të larta në Hollandë. <p><i>Në IAL mungon pasja e një politike të qartë mbi planifikimin e Sigurimit të cilësisë si dhe mungon kryerja e Raporteve periodike mbi sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon miratimin e rregulloreve specifike e të qarta mbi funksionimin e strukturave përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, si dhe kryerjen e raporteve periodike mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë në IAL.</i></p> <p>TBU, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, i është nënshtruar vlerësimeve të jashtme në kuadër të akreditimit të Institucionit si dhe programeve të studimit, dhe aktualisht është në procesin e vlerësimit periodik të programeve të studimit, midis të cilave edhe ky program që po vlerësohet.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



standardit		X		
------------	--	---	--	--

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	Sipas Statutit të TBU, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka funksionet si në vijim: 1. Vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore;
Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	2. Organizon, në fund të çdo semestri, pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi, në të cilin përfshihen informacione dhe vlerësime në lidhje me respektimin e standardeve shtetërore të cilësisë, në kuadrin institucional dhe atë të programeve të studimit;
Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	3. Realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni; 4. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë tjetër e parashikuar në statut ose në akte të tjera rregullatore;
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	5. Çdo përgjegjësi dhe/ose kompetencë që i njihet vetëm kësaj njësie nga LAL në fuqi, të aplikueshme në rastin e institucioneve jo publike të arsimit të lartë.
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	Më specifikisht, detyrat e kësaj njësie, janë të parashikuara në rregulloren e saj. Sipas rregullores së NJSBC, për çdo vit akademik, njësia përgatit Planin e Punës i cili miratohet nga Senati Akademik dhe përmban fushat që lidhen me: <i>Procesin arsimor</i> : numri i nevojshëm i profesorëve dhe bashkëpunëtorëve, planet e punës dhe planet operative për çdo lëndë; <i>Studentët</i> : numri i studentëve sipas viteve, udhëzime dhe treguese për studime të suksesshme; <i>Punën kërkimore-shkencore dhe arsimore si dhe veprimtarinë botuese, planifikimin e projekteve dhe publikimeve</i> ; <i>Bibliotekën</i> : sigurimin e botimeve të reja; <i>Hapësirën dhe pajisjet</i> : pajisjet e nevojshme themelore për punë; <i>Anketimet</i> ; <i>Vlerësimi i cilësisë së brendshme</i> . <i>Në dokumentacionin e përcjellë në kuadër të këtij vlerësimi, nuk evidentohet të jetë hartuar një plan pune nga ana e NJSBC, sikurse parashikuar më lart. GVJ rekomandon hartimin e një Plani pune për NJSBC në funksion të garantimit të cilësisë në IAL.</i> Gjetjet e aktiviteteve të realizuara nga NJSBC, sipas rregullores së



njësisë, përfshihen në një raport që hartohet prej tij, për çdo vit akademik, i cili u vihet në dispozicion të gjithë strukturave të TBU dhe pas paraqitjes dhe shqyrtimit të tij nga Senati Akademik, publikohet në faqen e internetit të Institucionit. Pas konsultimit të faqes zyrtare, GVJ konstaton se këto raporte janë të publikuara.

Gjithashtu, njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, bën monitorim të vazhdueshëm gjatë gjithë vitit, për të gjithë elementët e procesit mësimor. Në mbledhjet periodike të njësisë shqyrtohen dhe trajtohen çështje, që ngrihen gjatë procesit të monitorimeve apo në konkluzionet e nxjerra nga NJSBC, nga monitorimet që ajo ushtron për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë. Njësia bazë, bazuar në konkluzionet e nxjerra në mbledhje, informacionin e monitorimeve, treguesit e performancës periodike apo vjetore të studentëve, konkluzionet e monitorimeve të NJSBC, bën propozime në organet më të larta hierarkike për ndryshimet, që nevojiten të bëhen.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ, konstaton disa mangësi si në vijim:

- *mungon një analizë/relacion semestral i realizuar nga NJSBC për rezultatet e pyetësorit të studentëve; kjo mangësi evidentohet edhe në raportin vjetor të hartuar prej tij (18-19).*

- *në raportin vjetor të hartuar nga NJSBC (18-19) mungojnë rezultatet e pritshme dhe masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë nga ana e strukturave përgjegjëse;*

- *mangësitë e mësipërme reflektohen edhe në analizën e departamentit (18-19) mbi arritjen e objektivave të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional, si dhe në raportin vjetor të TBU (18-19), ku nuk pasqyrohet as puna dhe aktivitetet e realizuara nga njësia përgjatë vitit, dhe as gjetjet apo pikat për përmirësim në ardhmen.*

GVJ rekomandon që të kryhen analiza/raporte periodike të sigurimit të cilësisë, ku të përfshihen të gjitha aspektet e përmendura më lart, në mënyrë të detajuar.

Aneksi 2; Aneksi 8; Aneksi 30; Aneksi 38; Aneksi 47

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3


Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ, konstaton se NJSBC kryen vlerësime të brendshme të programit të studimit në mënyrë periodike, i cili është i përfshirë në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Metodat dhe instrumentet e përdorura nga njësia për kryerjen e këtij vlerësimi, janë të drejtpërdrejta si: vëzhgimi në auditor i leksioneve/seminareve, vlerësimi i kurrikulave të programit të studimit, ndjekje dhe monitorim gjatë testimit të studentëve; si dhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si: sondazhe e intervista të studentëve e të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, teste lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p><i>GVJ mendon që institucioni, për vlerësimin e programit mësimor, mund të përdorë edhe instrumenta të tjerë përveç atyre të përmendura më sipër, si psh. përdorimin e disa indikatorëve mes përputhjes së programit mësimor dhe tregut të punës, indikatorë të koherencës së programit mësimor me programe mësimore të ngjashme në Shqipëri ose jashtë vendit, etj.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor gjithashtu metodën e krahasimit të numrit të studentëve që zgjedhin këtë program mësimor në raport me programet e tjera, numrin e të punësuarve pas përfundimit të studimeve, numrin e studentëve që vazhdojnë kualifikimin në të njëjtin drejtim. <i>Aneksi 8; Aneksi 38; Aneksi 40; Aneksi 41; Aneksi 47</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>


Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
------------------------	--------------------------------------



<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka parashikuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm (<i>staf akademik, ndihmës akademik, staf administrativ dhe studentët</i>) për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm garantohej në aktet e brendshme rregullatore si Statut, Rregullore, Strategji Zhvillimi.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas Statutit të TBU, NJSBC përbëhet nga 3 anëtarë, të cilët përzgjidhen nga Senati Akademik. Në Rregulloren e NJSBC përcaktohet që 1 prej anëtarëve është përfaqësues i qeverisë studentore. Sikurse përmendur edhe më sipër, <i>në përbërjen e njësisë, sipas akteve rregullatore të IAL, nuk parashikohet si anëtar një ekspert apo bashkëpunëtor i jashtëm, megjithatë, gjatë veprimtarisë së tij, TBU ka përfshirë në njëfarë mënyrë ekspertizën e tyre.</i> Konkretisht:</p>			
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>- pranë TBU, që prej fillimit të veprimtarisë së tij, është ngritur dhe funksionon Bordi Ndërkombëtar Këshillimor, i cili ka ndihmuar në zhvillimin e strategjisë dhe ka kontribuar në disa aktivitete të tij; - në nëntor të vitit 2016 është realizuar një vlerësim nga një ekspert hollandez lidhur me performancën institucionale, ofertën akademike, impaktin e të nxënësve praktik të studentëve, shkallën e tërheqjes së studentëve në tregun e punës, si dhe për lehtësimin e vendosjes së kontakteve dhe bashkëpunimit me shkolla të larta në Hollandë.</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p><i>Në të ardhmen, IAL, mund të konsiderojë përfshirjen e ekspertit të jashtëm ai anëtar të përhershëm dhe aktiv të njësisë, për të siguruar një këndvështrim më gjithëpërfshirës, objektiv dhe efektiv të sigurimit të cilësisë në institucion.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjithashtu, në nivel institucioni dhe nivel fakulteti, është ngritur Komisioni i Cilësisë, një komision i përhershëm, i cili ka për detyrë garantimin e standardeve të cilësisë së Institucionit dhe programeve të studimit. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët 3 personel akademik dhe 2 studentë, dhe funksionon sipas një rregulloreje që miratohet nga Senati Akademik. Sikurse përmendur edhe më sipër, <i>Institucioni nuk ka një rregullore specifike ku të dalin në pah në mënyrë të qartë e të detajuar roli i komisionit, funksionet dhe veprimtaria që realizon, në përputhje me Statutin e IAL.</i></p> <p>GJVJ nuk ka indikatorë të përcaktuar përmes së cilëve të masë përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, por nga takimet me drejtuesit e Institucionit, stafin akademik dhe studentët, u konstatua respektimi i integritetit akademik dhe mungesa e diskriminimit.</p> <p><i>Aneksi 2; Aneksi 3.1; Aneksi 8; Aneksi 30</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>



standardit			X	
------------	--	--	---	--

Standardi VI.5
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ konstaton se në faqen zyrtare të internetit të TBU gjenden të publikuara Statuti, Rregulloret, Strategjitë, raportet vjetore të TBU dhe NJSBC, etj. Të dhënat e publikuara respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.			
Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe sikurse është përmendur edhe më lart, nuk evidentohet që NJSBC të ketë hartuar një plan masash apo të ketë dalë me rekomandime për përmirësim, të cilat tu jenë prezantuar strukturave përgjegjëse. GVJ nuk evidenton raporte vlerësuese për përmirësime të problematikave të mëparshme, qoftë të programit apo institucionit. GVJ rekomandon që institucioni të hartojë raporte në bazë programi të cilat të bëhen publike, ku të përfshihen mangësitë dhe dobësitë e evidentuara, plan programi i cili adreson përmirësimin e tyre, si dhe gjithashtu të raportojë vlerësimet e përmirësimit të këtyre mangësive dhe dobësive të evidentuara në periudhat e ardhshme.</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<i>Institucioni duhet të marrë masa për të siguruar efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, dhe impakti i tyre të jetë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<i>Nga takimet e realizuara gjatë vizitës në Institucion, GVJ, konstaton se TBU organizon takime periodike me stafin dhe studentët lidhur me informimin e tyre për sigurimin e cilësisë, mbarëvajtjen mësimore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të programit të studimit.</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<i>Aneksi 47; ëëë.tbu.edu.al</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor
në “E Drejtë Biznesi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Tirana Business
University College”**

Pika të forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Bachelor “E Drejtë Biznesi” ofron njohuri të përshtatshme për ushtrimin e profesionit të juristit në sektorin privat të biznesit dhe punësimin e studentëve edhe përpara përfundimit të studimeve (në zyra juridike apo në kompani biznesi), si dhe lëndët që ofrohen në program synojnë përputhjen e edukimit teorik me atë praktik/profesional.
2. Praktika profesionale/seminari special që është pjesë e këtij programi studimi përgjatë të tre viteve akademike, mundëson një aplikim në praktikë të njohurive të fituara në auditor.
3. Staf i akademik përdor metoda interaktive të mësimdhënies në lëndët që kanë në fokus të tyre praktikat gjyqësore. Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies të aplikuar në këtë program studimi kanë në qendër studentin.
4. Të gjitha njësitë akademike/kërkimore dhe njësitë e tjera ndihmëse janë në funksion të realizimit të procesit mësimor.
5. Institucioni dhe Fakulteti i Drejtësisë (si njësi kryesore) kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi efektive me institucione që operojnë në sektorin privat, që lidhen me zhvillimin e praktikave profesionale, trajnimeve përkatëse dhe më pas punësimin e studentëve.
6. TBU ka implementuar një sistem online interaktiv (Sistemi i Menaxhimit të Studentëve) që mundëson lehtësimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit.
7. Numri i reduktuar i studentëve ndihmon në një cilësi më të mirë në përvetësimin e njohurive, por edhe në një komunikim dhe bashkëpunim më të drejtpërdrejtë midis stafit akademik dhe studentëve.
8. Institucioni garanton një infrastrukturë fizike dhe informatike efektive, edhe për personat me nevoja të veçanta.
9. Biblioteka online dhe garantimi efektiv i aksesit në të si për studentët ashtu edhe për stafin, krijon mundësi reale për njohuri më të zgjeruara për studentët dhe sidomos për kërkim shkencor për stafin akademik të IAL.

Pika të dobëta:

1. Në programin e studimit Bachelor në “E Drejtë Biznesi” jo të gjithë titullarët e lëndëve/moduleve mbajnë titullin përkatës akademik sipas përcaktimeve në aktet ligjore përkatëse.
2. Disa prej teksteve të nevojshme për programin e studimit mungojnë, ka një numër të vogël të kopjeve të teksteve të disponueshme në bibliotekë, si dhe nuk rezulton që të

ketë një plan të detajuar për shtimin e zërave apo përditësimin e fondit ekzistues në bibliotekën e Institucionit.

3. Mbështetja e Institucionit për kërkim shkencor të stafit akademik është e kufizuar dhe jo e strukturuar në vazhdimësi dhe në bazë kriteresh të mirëpërcaktuara.
4. Mungojnë rregullore specifike për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Cilësisë dhe Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, ku të dalë në pah në mënyrë të qartë e të detajuar roli i këtyre komisioneve, funksionet e tyre dhe veprimtaria që realizojnë, sikurse parashikuar në Statutin e Institucionit.
5. Lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë evidentohen mangësitë si në vijim:
 - nuk evidentohet të jetë hartuar një plan pune nga ana e NJSBC;
 - nuk evidentohet të jetë hartuar një analizë/relacion semestral nga NJSBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;
 - në raportin vjetor të hartuar nga NJSBC nuk evidentohet një analizë mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve (përmendur në pikën më lart) dhe rezultatet e pritshme e masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë nga ana e strukturave përgjegjëse;
 - nuk evidentohet të jenë hartuar raporte vlerësuese për përmirësim të problematikave të mëparshme, qoftë të programit apo institucionit;
 - mangësitë e mësipërme reflektohen edhe në analizën e njësisë bazë mbi arritjen e objektivave të programit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisë profesionale, si dhe në raportin vjetor të TBU, ku nuk pasqyrohet as puna dhe aktivitetet e realizuara nga njësia përgjatë vitit, dhe as gjetjet apo pikat për përmirësim në të ardhmen.

Rekomandime:

1. Institucioni, të përcaktojë e angazhojë si titullarë të lëndëve/moduleve të programit të studimit, pedagogë që mbajnë titullin përkatës, sipas përcaktimeve në aktet ligjore përkatëse.
2. Institucioni, të përfshijë në bibliotekë të gjitha tekstet e parashikuara në programin e studimit, të shtojë numrin e kopjeve për tekst, si dhe të hartojë një plan të detajuar për shtimin e zërave në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues.
3. Institucioni, të mundësojë një mbështetje të strukturuar dhe të mirëpërcaktuar për kërkimin shkencor të stafit akademik.
4. Institucioni, të hartojë rregullore specifike për Komisionin e Cilësisë dhe Komisionin e Marrëdhënieve me Studentët, ku të dalë në pah në mënyrë të qartë e të detajuar roli i këtyre komisioneve, funksionet e tyre dhe veprimtaria që realizojnë, sikurse parashikuar në Statutin e IAL.
5. Institucioni, të marrë masa për të siguruar efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë dhe impaktin e tyre në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit, përmes sa më poshtë:
 - të hartohet një plan pune nga ana e NJSBC;
 - të hartohen analiza/relacione semestrale nga NJSBC mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve;

- në raportin vjetor të hartuar nga NJSBC të përfshihet edhe një analizë mbi rezultatet e pyetësorit të studentëve dhe rezultatet e pritshme e masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë nga ana e strukturave përgjegjëse;
 - të hartohen raporte në bazë programi të cilat të bëhen publike, ku të përfshihen mangësitë dhe dobësitë e evidentuara, plan programi i cili adreson përmirësimin e tyre, si dhe gjithashtu të raportojë vlerësimet e përmirësimit të këtyre mangësive dhe dobësive të evidentuara në periudhat e ardhshme;
 - të përfshihen në raportin vjetor të njësisë bazë sa më lart dhe sugjerimet apo rekomandimet e studentëve në lidhje me komponentët specifik të procesit mësimor.
6. Institucioni, të evidentojë në raportin vjetor të departamentit përkatës, rezultatet dhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet apo partnerët e biznesit, të cilat edhe pse janë pjesë e Raporteve Vjetore të TBU, duhet të pasqyrohen në mënyrë specifike edhe në raportin vjetor të departamentit.
 7. Institucioni, në procesin e rekrutimit të stafit, të ndjekë e zbatojë në mënyrë strikte, procedurat e parashikuara nga vetë Institucioni për këtë qëllim si dhe të sigurojë transparencë të plotë.
 8. Institucioni, të mundësojë realizimin e trajnimeve të stafit akademik mbi metodat inovative dhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie.
 9. Institucioni, të aplikojë një vlerësim elektronik për të rritur shkallën e transparencës dhe dhënien e informacionit në kohë reale për studentët.
 10. Institucioni, të publikojë në faqen e tij zyrtare të internetit syllabuset e këtij programi studimi, si dhe të plotësojë e përditësojë informacionin e paraqitur për këtë program në faqen e tij zyrtare, në mënyrë që informacioni të jetë i plotë dhe i aksesueshëm nga kushdo.

Conclusions of the evaluation of the first cycle study program Bachelor in “Business Law”, of the Institution of Higher Education “Tirana Business University College”

Strengths and affirmations:

1. Bachelor in “Business Law” study program provides appropriate knowledge for practicing the profession of lawyer in the private business sector and the employment of students even before the completion of studies (in law offices or business companies), as well as the courses offered in the program aim at matching theoretical education with practical/professional education.

2. Professional practice/special seminar that is part of this study program during the three academic years, enables an application in practice of the knowledge gained in the auditorium.
3. Academic staff use interactive teaching methods in subjects that focus on court practice. The forms of teaching and learning applied in this study program are student-centered.
4. All academic/research units and other auxiliary units are in function of the realization of the teaching process.
5. The Institution and the Faculty of Law (as the main unit) have signed effective cooperation agreements with institutions operating in the private sector, related to the development of professional internships, relevant training and subsequent employment of students.
6. TBU has implemented an online interactive system (Student Management System) that enables the facilitation of interactive communication and exchange of information between students and staff.
7. The reduced number of students helps in a better quality in the acquisition of knowledge, but also in a more direct communication and cooperation between the academic staff and the students.
8. The institution guarantees an effective physical and informational infrastructure, even for people with special needs.
9. The online library and the effective guarantee of access to it for both students and staff, creates real opportunities for more extensive knowledge for students and especially for research for the academic staff of HEI.

Weaknesses:

1. In the Bachelor in "Business Law" study program not all first lecturers of courses/modules have the relevant academic title as defined in the relevant legal acts.
2. Some of the textbooks needed for the study program are missing, there are a small number of copies of textbooks available in the library, and it does not appear that there is a detailed plan for adding items or updating the existing fund in the library of the institution.
3. The support of the Institution for scientific research of the academic staff is limited and not continuously structured and based on well-defined criteria.
4. There are no specific regulations for the organization and functioning of the Quality Commission and the Student Relations Commission, which clearly and in detail highlight the role of these commissions, their functions and the activity they carry out, as provided in the Statute of the institution.
5. Regarding the internal quality assurance, the following shortcomings are identified:
 - it is not evidenced that a work plan has been drafted by the IQAU;
 - it is not evidenced that a semester analysis/report has been drafted by the IQAU on the results of the student questionnaire;
 - the annual report drafted by the IQAU does not show an analysis of the results of the student questionnaire (mentioned in the point above) and the expected

results and measures to be taken to address the shortcomings and subsequent quality improvement by the responsible structures;

- it is not evidenced that evaluation reports for improvements of previous issues have been drafted, whether of the program or the institution;
- the above shortcomings are also reflected in the analysis of the basic unit on achieving the objectives of the program and the expected results of learning and vocational training, as well as in the annual report of TBU, which does not reflect the work and activities carried out by the unit during the year, nor findings or points for future improvement.

Recommendations:

1. The institution, has to define and engage as first lecturers of subjects/modules of the study program, pedagogues who hold the respective title, according to the definitions in the relevant legal acts.
2. The institution, has to include in the library all the texts foreseen in the study program, to increase the number of copies for text, as well as to draft a detailed plan for adding items in the library and updating the existing fund.
3. The institution, has to provide a structured and well-defined support for the scientific research of the academic staff.
4. The Institution, has to draft specific regulations for the Quality Commission and the Student Relations Commission, which clearly and in detail highlight the role of these commissions, their functions and the activity they carry out, as provided in the Statute of the HEI.
5. The institution, has to take measures to ensure the effectiveness of activities in the framework of quality monitoring and evaluation and their impact on the subsequent improvement of the quality of the study program, through the following:
 - IQAU has to draft a working plan;
 - IQAU has to draft semester analyzes/reports on the results of the students questionnaire;
 - the annual report prepared by IQAU has to include also an analysis on the results of the students questionnaire and the expected results and measures to be taken to address the shortcomings and subsequent quality improvement by the responsible structures;
 - to be drafted reports based on the program which will be made public, including the identified deficiencies and weaknesses, the program plan which addresses their improvement, as well as to report the assessments of the improvement of these deficiencies and weaknesses identified in the coming periods;
 - to be included in the annual report of the basic unit as above and the suggestions or recommendations of the students regarding the specific components of the learning process.
6. The institution, has to identify in the annual report of the relevant department, the results and benefits of cooperation agreements with institutions or business partners,


which although are part of the Annual Reports of TBU, should be specifically reflected in the annual report of department.

7. The Institution, in the process of staff recruitment, to strictly follow and implement the procedures provided by the Institution for this purpose and to ensure full transparency.
8. The institution, has to enable the realization of trainings of the academic staff on innovative methods and the use of technology in teaching.
9. The institution, has to apply an electronic assessment to increase the transparency and provide real-time information to students.
10. The institution, has to publish on its official website the syllabuses of this study program, as well as to add and update the information presented for this program on its official website, so that the information is complete and accessible by anyone.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Enkeleda OLLDASHI

2. PhD. Robert GAJDA



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushet	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE		X		
VLERËSIMI TËRËSOR			X	